

**AKTI I GJENEVËS
MBI MARRËVESHJEN E HAGËS
LIDHUR ME REGJISTRIMIN
NDËRKOMBËTAR TË DIZAJNIT
INDUSTRIAL**

I shpallur në "Gazetën zyrtare të RM-së" nr.33/05

Përmbajtja

Dispozitat hyrëse:

- Neni 1; Shprehje të shkurtuara
Neni 2: Zbatueshmëria e mbrojtjeve të tjera në përputhje me ligjet e Palëve nënshkruese dhe marrëveshjeve ekzistuese ndërkombëtare

Kapitulli I: Aplikimi ndërkombëtar dhe regjistrimi ndërkombëtar

- Neni 3: E drejta për dorëzimin e aplikacionit ndërkombëtar
Neni 4: Procedura për plotësimin e aplikacionit ndërkombëtar
Neni 5: Përmbajtja e aplikacionit ndërkombëtar
Neni 6: Prioriteti
Neni 7: Taksa e përcaktimit
Neni 8: Korrigjimi i gabimeve
Neni 9: Data e dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar
Neni 10: Regjistrimi ndërkombëtar, data e regjistrimit ndërkombëtar, shpallja dhe kopjet e besueshme të regjistrimit ndërkombëtar
Neni 11: Prolongimi i shpalljes
Neni 12: Refuzimi
Neni 13: Kërkesa të veçanta që kanë të bëjnë me unitetin e dizajnit
Neni 14: Rëndësia e regjistrimit ndërkombëtar
Neni 15: Shfuqizimi
Neni 16: Regjistrimi i ndryshimeve dhe çështje të tjera lidhur me regjistrimin ndërkombëtar
Neni 17: Periudha fillestare dhe ripërtëritja (renovimi) i regjistrimit ndërkombëtar dhe kohëzgjatja e mbrojtjes
Neni 18: Informacione lidhur me regjistrimet e shpallura ndërkombëtare

Kapitulli II: Dispozita administrative

- Neni 19: Enti i përbashkët për disa shtete
Neni 20: Anëtarësimi në Unionin e Hagës
Neni 21: Kuvendi
Neni 22: Byroja ndërkombëtare
Neni 23: Financat
Neni 24: Rregulloret

Kapitulli III: Rishikime dhe plotësime

- Neni 25: Rishikimi i këtij akti
Neni 26: Plotësimi i neneve ekzistuese nga ana e Kuvendit

Kapitulli IV: Dispozitat përfundimtare

- Neni 27: Të bërit pjesë e këtij Akti
 Neni 28: Data e hyrjes në fuqi të ratifikimit dhe aderimit (qasjes)
 Neni 29: Ndalesë për rezervime
 Neni 30: Deklarata të bëra nga palët nënshkruese
 Neni 31: Zbatimi i akteve nga viti 1934 dhe 1960
 Neni 32: Tërheqje nga ky akt
 Neni 33: Gjuhët e këtij Akti; Nënshkrimi
 Neni 34: Depozitar

DISPOZITA HYRËSE

Neni 1 Shprehje të shkurtuara

Për qëllimet e këtij Akti:

- (i) "Marrëveshja e Hagës" do të thotë Marrëveshja e Hagës që ka të bëjë me depozitimin ndërkombëtar të dizajnit industrial, më vonë i riemëruar në Marrëveshje të Hagës lidhur me regjistrimin ndërkombëtar të dizajnit industrial;
- (ii) "Ky Akt" do të thotë Marrëveshja e Hagës e sjellë sipas aktit ekzistues;
- (iii) "Rregullore" do të thotë Rregullorja sipas këtij Akti;
- (iv) "Përshkruar (paraparë)" do të thotë e përshkruar sipas Rregullores;
- (v) "Konventa e Parisit" do të thotë Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, e nënshkruar më 20 mars të vitit 1883, e rishikuar dhe plotësuar;
- (vi) "Regjistrimi ndërkombëtar" do të thotë regjistrimi ndërkombëtar i dizajnit industrial sipas këtij Akti;
- (vii) "Aplikacioni ndërkombëtar" do të thotë aplikacion për regjistrim ndërkombëtar;
- (viii) "Regjistri ndërkombëtar" do të thotë grumbullimi zyrtar i të dhënave në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar të cilin e udhëheq Byroja Ndërkombëtare, të dhëna që kërkon ose lejon të arkivohen ky Akt apo Rregullorja, pa marrë parasysh mediumin në të cilin këto të dhëna ruhen;
- (ix) "Person" do të thotë person fizik ose juridik;
- (x) "Aplikues" do të thotë personi në emër të të cilit është dorëzuar aplikacioni ndërkombëtar
- (xi) "Bartës" do të thotë personi në emër të të cilit është regjistruar (evidentuar) regjistrimi ndërkombëtar në Regjistrin Ndërkombëtar
- (xii) "Organizatata ndërqeveritare" do të thotë organizatat ndërqeveritare të cilat mund të bëhen palë në këtë Akt sipas nenit 27(1)(ii);
- (xiii) "Palët nënshkruese" do të thotë shtetet ose organizatat ndërqeveritare anëtare të këtij Akti;
- (xiv) "Pala nënshkruese e aplikuesit" do të thotë pala nënshkruese ose një nga Palët nënshkruese nga e cila aplikuesi fiton të drejtën të dorëzojë aplikacion ndërkombëtar në sajë të përmbushjes, në lidhje me atë palë

- nënshkruese, të më së paku një nga kushtet e specifikuar në Nenin 3; në rast kur ka dy apo më shumë palë nënshkruese prej ku aplikuesi mund, sipas nenit 3, të fitojë të drejtën për të dorëzuar aplikacion ndërkombëtar;
- (xv) "Territori i Palës nënshkruese" do të thotë, në rastin kur pala nënshkruese është shtet, territori i atij shteti dhe, kur pala nënshkruese është organizatë ndërqeveritare, territori mbi të cilin zbatohet marrëveshja e organizatës ndërqeveritare;
- (xvi) "Enti" do të thotë agjencia, të cilës Pala nënshkruese ia beson punën për mbrojtjen e dizajnit industrial, që është në territorin e Palës nënshkruese;
- (xvii) "Zyra për shqyrtime" do të thotë enti i cili *ex officio* i shqyrton (ekzaminon) aplikacionet e dorëzuara për mbrojtjen e dizajnit industrial me qëllim përcaktimi se a i përmbush dizajni industrial kushtet për risi (diçka e re);
- (xviii) "Përcaktimi" do të thotë kërkesa që regjistrimi ndërkombëtar të ketë vlefshmëri në Palën nënshkruese; gjithashtu do të thotë edhe evidentimin e asaj kërkesë në Regjistrin ndërkombëtar;
- (xix) "Pala nënshkruese e përcaktuar" dhe "Enti i përcaktuar" do të thotë Pala nënshkruese ose Enti mbi të cilat ka të bëjë përcaktimi;
- (xx) "Akti i vitit 1934" do të thotë Akti i Marrëveshjes së Hagës i nënshkruar në Londër më 2 qershor të vitit 1934;
- (xxi) "Akti i vitit 1960" do të thotë Akti i Marrëveshjes së Hagës i nënshkruar në Hagë më 28 nëntor të vitit 1960;
- (xxii) "Akti shtesë i vitit 1961" do të thotë Akti i cili është plotësim (shtesë) e Aktit të vitit 1934, i nënshkruar në Monako më 18 nëntor të vitit 1961;
- (xxiii) "Akti shtesë i vitit 1967" do të thotë Akti shtesë i Marrëveshjes së Hagës i nënshkruar në Stokholm më 14 korrik të vitit 1967;
- (xxiv) "Unioni" do të thotë Unioni i Hagës sipas marrëveshjes së Hagës të 6 nëntorit të vitit 1925, i vërtetuar me aktin e vitit 1934 dhe 1960, me aktin shtesë të vitit 1961, me aktin shtesë të vitit 1967 dhe me këtë Akt;
- (xxv) "Kuvendi" do të thotë Kuvendi nga neni 21(1)(a) apo trup tjetër zëvendësues;
- (xxvi) "Organizata" do të thotë Organizata Botërore për mbrojtjen e pronësisë industriale;
- (xxvii) "Drejtori gjeneral" do të thotë drejtori gjeneral i Organizatës;
- (xxviii) "Byroja ndërkombëtare" do të thotë Byroja ndërkombëtare e Organizatës;
- (xxix) "Instrument për ratifikim" do të thotë instrumentet e dorëzuara për praninë ose pëlqim.

Neni 2

Zbatueshmëria e mbrojtjeve të tjera sipas ligjeve të Palëve nënshkruese dhe marrëveshjeve ekzistuese ndërkombëtare

- (1) [Ligjet e Palëve nënshkruese dhe marrëveshjet ekzistuese

ndërkombëtare] Dispozitat nga ky Akt nuk do të kenë ndikim mbi zbatimin e mbrojtjes më të madhe që mund të njihet sipas ligjit të palës nënshkruese, e as që do të ketë ndikim mbi mbrojtjen e veprave artistike apo veprave nga arti i aplikuar që janë të mbrojtura sipas marrëveshjeve dhe konventave për mbrojtjen e të drejtës autoriale, ose mbi mbrojtjen e dizajnit industrial sipas Marrëveshjes TRIPS si shtesë e Marrëveshjes për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë.

(2) [Detyrimi për harmonizim me Konventën e Parisit]. Çdo palë nënshkruese do të pranojë (përmesh) dispozitat e Konventës së Parisit lidhur me dizajnin industrial.

KAPITULLI I: APLIKACIONI NDËRKOMBËTAR DHE REGJISTRIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 3

E drejta për dorëzimin (parashtrimin) e aplikacionit ndërkombëtar

Çdo person që është shtetas i vendit që është Palë nënshkruese ose shtetit anëtar të organizatës ndërqeveritare që është palë nënshkruese, ose që ka vendqëndrim ose ka ndërmarrje të vërtetë dhe efektive industriale apo komerciale në territorin e Palës nënshkruese, ka të drejtë të dorëzojë (parashtrijë) aplikacion ndërkombëtar.

Neni 4

Procedura për dorëzimin e aplikacionit ndërkombëtar

(1) [Dorëzimi i drejtpërdrejt ose indirekt] (a) Aplikacioni ndërkombëtar mund të dorëzohet, sipas zgjedhjes së aplikuesit, drejtpërdrejt në Byronë ndërkombëtare ose përmes Entit të palës nënshkruese të aplikuesit.

(b) Përkundër paragrafit (a), çdo palë nënshkruese mund, me deklaratë, të njoftojë Drejtorin gjeneral se aplikacioni ndërkombëtar nuk mund të dorëzohet përmes Entit të saj.

(2) [Taksa për bartje (transferim) në rast të dorëzimit indirekt] Enti i çdo Pale nënshkruese mund të kërkojë nga aplikuesi, pagesë të taksave për transferim, për nevojë të veta, në lidhje me çdo aplikim ndërkombëtar të dorëzuar tek ai.

Neni 5

Përmbajtja e aplikacionit ndërkombëtar

(1) [Përmbajtja e obligueshme e aplikacionit ndërkombëtar] Aplikacioni ndërkombëtar duhet të dorëzohet në gjuhën e përcaktuar ose në njërën nga gjuhët e përcaktuara dhe duhet të shoqërohet me:

- (i) kërkesë për regjistrim ndërkombëtar sipas këtij Akti;
- (ii) të dhënat e përshkruara (përcaktuara) në lidhje me aplikuesin;
- (iii) numër të përcaktuar të kopjeve të riprodhimit ose, sipas zgjedhjes së aplikuesit, disa riprodhime të ndryshme të dizajnit industrial që është lëndë e aplikacionit ndërkombëtar, i paraqitur (prezantuar) në mënyrën e përcaktuar; në raste kur dizajni industrial është dydimensional dhe kur kërkesa për prolongimin e shpalljes është dorëzuar në pajtim me nenin (5), aplikacioni ndërkombëtar mund, në vend të riprodhimit, të shoqërohet me numrin e përcaktuar të mostrave (ekzemplarë) të dizajnit industrial;
- (iv) tregues (indikacion) të produktit ose produkteve që janë pjesë përbërëse e dizajnit industrial ose kanë lidhje me dizajnin industrial, siç është përshkruar.
- (v) Përcaktim të palëve nënshkruese;
- (vi) Taksa e përcaktuar;
- (vii) të gjitha çështjet tjera të përshkruara (përcaktuara).

(2) [Përmbajtje tjera shtesë të obligueshme të aplikacionit ndërkombëtar]
(a) Çdo palë nënshkruese, Enti i së cilës është Ent shqyrtues (ekzaminues) dhe ligji i së cilës, në kohën ajo është bërë pjesë e këtij Akti kërkon që aplikacioni për njohjen e mbrojtjes së dizajnit industrial të përmbajë ndonjë nga elementët e specifikuar në pikën (6) me qëllim që aplikacioni të dorëzohet sipas atij ligji, përmes një deklarate, e njofton drejtorin gjeneral për këto elemente.

(b) Elementët të cilat mund të dorëzohen si njoftim sipas pikës (a) janë si në vijim:

- (i) Tregues (indikatorë) që kanë të bëjnë me identifikimin e kreatorit të dizajnit industrial që është lëndë e aplikacionit;
- (ii) Përshkrim i shkurtë i riprodhimit ose i prezantimeve karakteristike të dizajnit industrial që është lëndë e aplikacionit;
- (iii) kërkesë

c) Kur aplikacioni ndërkombëtar përmban përcaktimin e palës nënshkruese e cila ka njoftuar sipas pikës 9(a), ai gjithashtu përmban, në mënyrë të përshkruar, çdo element që është lëndë e atij njoftimi.

(3) [Përmbajtje të tjera të mundshme të aplikacionit ndërkombëtar] Aplikacioni ndërkombëtar mund të përmbajë ose të shoqërohet me elementë të tjerë që janë specifikuar me Rregullore.

(4) [Disa dizajnë industrial në lidhje me aplikacionin ndërkombëtar]
Në përputhje me këto dispozita siç mund të përshkruhet, aplikacioni ndërkombëtar mund të përfshijë dy ose më shumë dizajnë industrial.

(5) [Kërkesë për prolongim të shpalljes] Aplikacioni ndërkombëtar mund të përmbajë kërkesë për prolongim të shpalljes.

Neni 6 **Prioriteti**

(1) [Kërkesë për prioritet] (a) Aplikacioni ndërkombëtar mund të përmbajë deklaratë për kërkesë sipas nenit 4 të Konventës së Parisit për prioritet të një ose më shumë aplikimeve të mëhershme të dorëzuara ose për ndonjë palë të Konventës ose ndonjë anëtar të Organizatës Botërore të Tregtisë.

(b) Rregullorja mund të parashohë që deklarata e cekur në pikën (a) të bëhet pas dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar. Në rast të tillë, Rregullorja do të përshkruaj periudhën kur deklarata e tillë për kërkesë më së voni mund të dorëzohet.

(2) [Aplikacioni ndërkombëtar si bazë për kërkesë të prioritetit] Aplikacioni ndërkombëtar, nga data e dorëzimit ose nga çfarëdo date tjetër të mëvonshme do të jetë ekuivalente me dorëzimin e rregullt në kuptimin e nenit 4 të Konventës së Parisit.

Neni 7 **Taksa për përcaktim**

(1) [Taksa e përshkruar për përcaktim] Taksat e përshkruara në rast se janë lëndë e paragrafit (2) përfshijnë taksën për përcaktim për çdo palë të përcaktuar nënshkruese.

(2) [Taksa individuale për përcaktim] Çdo palë nënshkruese Enti i së cilës është Ent shqyrtues (ekzaminues) dhe çdo palë nënshkruese që është organizatë ndërqeveritare mund, përmes deklaratës, të njoftojë Drejtorin gjeneral se, në lidhje me çdo aplikacion ndërkombëtar në të cilin është përcaktuar dhe në lidhje me renovimin (ripërtëritjen) e regjistrimit ndërkombëtar, taksa e përshkruar për përcaktim sipas paragrafit (1) do të zëvendësohet me taksën individuale për përcaktim, shuma e së cilës do të potencohet në deklaratë dhe mund të ndryshohet në deklaratat vijuese. Shuma në fjalë mund të përcaktohet nga pala nënshkruese në fjalë për periudhën fillestare të mbrojtjes dhe për çdo periudhë të renovimit ose për periudhën maksimale të mbrojtjes të lejuar nga pala nënshkruese për të cilën bëhet fjalë. Sidoqoftë, ajo nuk mund të jetë më e lartë se ekuivalenti i shumës të cilën Enti i asaj pale nënshkruese do të ishte i autorizuar ta pranojë nga aplikuesi për mbrojtjen e regjistruar për periudhën ekuivalente për numrin e njëjtë të dizajneve industrial, ajo shumë mund të zvogëlohet përmes

kursimeve që është rezultat i procedurës ndërkombëtare.

(3) [Transferimi i taksës për përcaktim] Taksat për përcaktim, sipas paragrafëve (1) dhe (2), do të transferohen nga Byroja ndërkombëtare tek Pala nënshkruese për të cilën janë paguar ato taksa.

Neni 8 **Korrigjimi i gabimeve**

(1) [Ekzaminimi i aplikacionit ndërkombëtar] Nëse Byroja ndërkombëtare zbulon se aplikacioni ndërkombëtar në kohën e pranimit të tij nga Byroja ndërkombëtare nuk i plotëson kërkesat e këtij Akti dhe ato të rregullores, ajo do të ftojë aplikuesin të kryej korrigjimet e kërkuara në afat kohor të përcaktuar.

(2) [Gabime të pakorrigjueshme] (a) Nëse aplikuesi nuk i përgjigjet ftesës në afat të paraparë kohor, aplikacioni ndërkombëtar, lëndë e nënparagrafit (b) do të konsiderohet i anuluar.

(b) Në rast të gabimit që ka të bëjë me nenin 5(2) ose me kërkesën e veçantë me të cilën njoftohet Drejtori gjeneral nga ana e palës nënshkruese në lidhje me Rregulloren, në qoftë se aplikuesi nuk i përgjigjet ftesës në periudhë të paraparë kohore, do të konsiderohet se aplikacioni ndërkombëtar nuk përmban shenjë (tregues) për atë palë nënshkruese.

Neni 9 **Data e dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar**

(1) [Dorëzimi i drejtpërdrejt i aplikacionit ndërkombëtar] Kur aplikacioni ndërkombëtar dorëzohet drejtpërdrejt në Byronë ndërkombëtare, data e dorëzimit, sipas nenit (3) do të jetë ajo datë në të cilën Byroja ndërkombëtare ka pranuar aplikacionin ndërkombëtar.

(2) [Dorëzimi indirekt i aplikacionit ndërkombëtar] Kur aplikacioni ndërkombëtar është dorëzuar përmes Entit të Palës nënshkruese të aplikuesit, data e dorëzimit përcaktohet ashtu siç është paraparë.

(3) [Aplikacioni ndërkombëtar me disa gabime] Kur aplikacioni ndërkombëtar, në datën kur është pranuar në Byronë ndërkombëtare, ka ndonjë gabim që është përshkruar si gabim që shkakton prolongim të datës së dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar, data e dorëzimit do të jetë data në të cilën është pranuar nga Byroja ndërkombëtare korrigjimi i atij gabimi.

Neni 10 **Regjistrimi ndërkombëtar, data e regjistrimit ndërkombëtar, shpallja dhe**

kopjet e besueshme të regjistrimit ndërkombëtar

(1) [Regjistrimi ndërkombëtar] Byroja ndërkombëtare do të regjistrojë çdo dizajn industrial që është lëndë e aplikacionit ndërkombëtar menjëherë pas pranimit të aplikacionit ndërkombëtar, ose kur kërkohen ndryshime sipas nenit 8, menjëherë pas pranimit të ndryshimeve të kërkuara. Regjistrimi hyn në fuqi pa marrë parasysh atë se kërkohet apo jo shpallje sipas nenit 11.

(2) [Data e regjistrimit ndërkombëtar] (a) Lëndë e pikës (b), për datë të regjistrimit ndërkombëtar konsiderohet data e dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar.

(b) Kur aplikacioni ndërkombëtar, në datën kur është pranuar në Byronë ndërkombëtare, ka parregullsi që është në lidhje me nenin 5(2), data e regjistrimit ndërkombëtar do të jetë data në të cilën korrigjimi i asaj parregullsie është pranuar nga ana e Byrosë ndërkombëtare ose data e dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar në varësi të asaj se cila nga këto është e mëvonshme.

(3) [Shpallja] (a) Regjistrimi ndërkombëtar do të shpallet nga Byroja ndërkombëtare. Kjo shpallje do të bëhet me dije për të gjitha palët nënshkruese dhe nga bartësi nuk kërkohet asnjë lloj tjetër publiciteti (shpallje).

(b) Byroja ndërkombëtare do të dërgojë kopje të shpalljes për regjistrimin ndërkombëtar deri tek Entet e përcaktuara.

(4) [Mbajtja e konfidencialitetit para shpalljes] Sipas paragrafit (5) dhe nenit 11(4)(6), Byroja ndërkombëtare do të ruaj në fshehtësi çdo aplikacion ndërkombëtar dhe çdo regjistrim ndërkombëtar deri në shpalljen e tyre.

(5) [Kopje të besueshme] (a) Byroja ndërkombëtare, menjëherë pasi regjistrimi të hyjë në fuqi, do të dërgojë kopje të regjistrimit ndërkombëtar, bashkë me të gjitha deklaratat relevante, dokumente apo mostra që shoqërojnë aplikacionin ndërkombëtar, deri tek secili Enti që ka njoftuar Byronë ndërkombëtare se dëshiron të pranojë kopje të tillë dhe që është përcaktuar në aplikacionin ndërkombëtar.

(b) Enti, deri në shpalljen e regjistrimit ndërkombëtar nga ana e Byrosë ndërkombëtare, do të ruaj në fshehtësi çdo regjistrim ndërkombëtar për të cilin i është dërguar kopje nga Byroja ndërkombëtare dhe kopjen në fjalë mund ta përdor vetëm për qëllime të shqyrtimit (ekzaminimit) të regjistrimit ndërkombëtar dhe të aplikacioneve për mbrojtje të dizajnit industrial në ose për Palën nënshkruese komponentë e së cilës është Enti. Në veçanti, ai nuk mund të zbulojë përmbajtjen e ndonjë regjistrimi ndërkombëtar të ndonjë personi jashtë Entit që nuk është bartës i regjistrimit ndërkombëtar, përveç për qëllime të procedurës administrative apo ligjore në lidhje me ndonjë konflikt që ka të bëjë me dorëzimin e aplikacionit ndërkombëtar mbi të cilën bazohet regjistrimi ndërkombëtar. Në rast të një procedure të tillë administrative apo ligjore, përmbajtja e regjistrimit ndërkombëtar mund t'i

zbulohet në konfidencialitet palëve të përfshira në procedurë, dhe ata do të obligohen në konfidencialitet të atij zbulimi.

Neni 11 **Shtyrja e afatit të shpalljes**

(1) [Dispozita ligjore të palëve nënshkruese që kanë të bëjnë me shtyrjen e afatit të shpalljes] (a) Kur ligji i palës nënshkruese për shtyrje të shpalljes së dizajnit industrial mundëson periudhë që është më e shkurtë nga e përshkruara, Pala nënshkruese, me deklaratë deri tek Drejtori gjeneral do të njoftojë për periudhën e shtyrjes.

(b) Kur ligji i palës nënshkruese nuk parasheh shtyrje të shpalljes së dizajnit industrial, Pala nënshkruese mundet, përmes deklaratës, ta njoftojë drejtorin gjeneral për këtë.

(2) [Shtyrja e shpalljes] Kur aplikacioni ndërkombëtar përmban kërkesë për shtyrje të shpalljes, shpallja do të realizohet,

- (i) kur asnjë nga palët nënshkruese të përcaktuara në aplikacionin ndërkombëtar nuk ka dorëzuar deklaratë sipas paragrafit (1), për tejkalim të periudhës së përshkruar, ose
- (jj) kur ndonjë nga palët nënshkruese të përcaktuara në aplikacionin ndërkombëtar ka dorëzuar deklaratë sipas paragrafit 14(1)(a), pas kalimit të periudhës së potencuar në atë deklaratë ose, kur ka më shumë se një palë të përcaktuar nënshkruese, pas skadimit të periudhës më të shkurtë të potencuar në deklaratat e tyre.

(3) [Trajtimi i kërkesave për shtyrje kur shtyrja nuk është e mundur në përputhje me të drejtën e zbatueshme] Kur është kërkuar shtyrje të shpalljes dhe kur ndonjë nga palët nënshkruese të përcaktuara në aplikacionin ndërkombëtar kanë dorëzuar deklaratë sipas paragrafit (1)(6) se shtyrja e shpalljes nuk është mundur sipas ligjeve të tyre,

- (I) në përputhje me pikën (ii), Byroja ndërkombëtare menjëherë do të njoftojë aplikuesin; në qoftë se aplikuesi, në afatin e paraparë, me njoftim të shkruar drejtuar deri tek Byroja ndërkombëtare, nuk e tërheq përcaktimin për palën nënshkruese në fjalë, Byroja ndërkombëtare do të injorojë kërkesën për shtyrje të shpalljes.
- (II) Kur në vend të riprodhimeve të dizajnit industrial, aplikacioni ndërkombëtar përmban mostra të dizajnit industrial, Byroja ndërkombëtare do të injorojë kërkesën për palën nënshkruese në fjalë dhe menjëherë për atë do ta njoftojë aplikuesin.

(4) [Kërkesë për shpallje të parakohshme ose për qasje të veçantë në regjistrimin ndërkombëtar] (a) Në çdo kohë gjatë periudhës së shtyrjes sipas paragrafit (2), bartësi mund të kërkojë shpalljen e një pjese ose të të gjitha

dizajnëve industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar, me ç'rast periudha e shtyrjes në lidhje me atë dizajn industrial apo ata dizajnë industrial do të konsiderohet të ketë skaduar në datën e pranimit të asaj kërkesë nga Byroja ndërkombëtare.

(b) Bartësi mundet, gjithashtu, në çdo kohë në periudhën e shtyrjes të aplikuar sipas paragrafit (2), të kërkojë nga Byroja ndërkombëtare që t'i dorëzojë palës së tretë të specifikuar nga ai, ekstrakt nga formulari, ose t'i mundësojë asaj pale qasje në ndonjë ose në të gjitha dizajnet industriale që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar.

(5) [Tërheqje dhe kufizime] (a) Nëse, në çfarëdo qoftë kohe nga periudha e shtyrjes të zbatuar sipas paragrafit (2), bartësi tërhiqet nga regjistrimi ndërkombëtar tek të gjithë palët nënshkruese të përcaktuara, dizajni industrial ose dizajnet industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar nuk do të shpallen.

(b) Nëse, në çfarëdo qoftë kohe nga periudha e shtyrjes të zbatuar sipas paragrafit (2), bartësi e kufizon regjistrimin ndërkombëtar për të gjithë palët nënshkruese të përcaktuara, për një ose më shumë dizajnë që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar, dizajni ose dizajnet i mbetur industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar nuk do të shpallen.

(6) [Shpallja dhe kompletimi i riprodhimeve] (a) Pas skadimit të çdo periudhe të shtyrjes, të zbatuar sipas dispozitave nga ky nen, Byroja ndërkombëtare, pas pagesës së kryer të taksës së paraparë, do ta publikojë regjistrimin ndërkombëtar. Nëse këto taksa nuk janë paguar siç është parashikuar, regjistrimi ndërkombëtar do të anulohet dhe nuk do të shpallet.

(b) Kur aplikacioni ndërkombëtar është i shoqëruar me një ose më shumë mostra të dizajnit industrial sipas nenit 5(1)(iii), bartësi do të dorëzojë deri tek Byroja ndërkombëtare numrin e parashikuar të kopjeve të riprodhimit për çdo dizajn industrial që është lëndë e aplikacionit, në periudhë të përcaktuar kohore. Nëse bartësi nuk e bënë këtë, regjistrimi ndërkombëtar do të anulohet dhe nuk do të publikohet.

Neni 12 ***Refuzimi***

(1) [E drejta e refuzimit] Enti i çdo pale nënshkruese të përcaktuar, aty ku nuk ekzistojnë kushte për njohje të mbrojtjes sipas ligjit të palës nënshkruese në lidhje me ndonjë ose të gjithë dizajnet industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar, mund ta refuzojë, pjesërisht ose në tërësi, regjistrimin ndërkombëtar në territorin e palës nënshkruese në fjalë, se asnjë Ent nuk mund të refuzojë, pjesërisht ose në tërësi, ndonjë regjistrim ndërkombëtar në bazë të kërkesave që kanë të bëjnë me formën ose përmbajtjen e aplikacionit ndërkombëtar të paraparë me këtë Akt, ose me rregulloren ose janë shtuar ose janë të ndryshme nga ato kërkesa që nuk janë plotësuar sipas ligjit të palës nënshkruese në fjalë.

(2) [Njoftim për refuzim] (a) Refuzimi i vlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar do të kryhet përmes komunikimit nga Enti deri tek Byroja ndërkombëtare në njoftim për refuzim, në periudhë të përcaktuar.

(b) Çdo njoftim për refuzim do të përmbajë të gjitha arsyet mbi të cilat ai refuzim bazohet.

(3) [Dorëzimi i njoftimit për refuzim; mjetet juridike] (a) Byroja ndërkombëtare, pa vonesa, do të dorëzojë kopje të njoftimit për refuzim deri tek bartësi.

(b) Bartësi do të gëzojë të gjitha mjetet juridike sikur çdo dizajn industrial që është lëndë e regjistrimit ndërkombëtar të ketë qenë lëndë e aplikimit për njohjen e mbrojtjes të dorëzuar sipas ligjit të zbatueshëm në Entin që ka komunikuar refuzimin. Këto mjete juridike më së shumti përbëhen nga mundësia për riezaminim ose rishqyrtim të refuzimit ose të ankesës kundër refuzimit.

(4) [Tërheqja e refuzimit] Çdo refuzim mund të tërhiqet, pjesërisht ose në tërësi, në çdo kohë nga ana e Entit që ka dorëzuar.

Neni 13

Kërkesa të veçanta lidhur me unitetin e dizajnit

(1) [Njoftim për kërkesa të veçanta] Çdo palë nënshkruese, ligji i së cilës, kur ajo është bërë pjesë e këtij Akti, kërkon që dizajnet të cilët janë në aplikacion të njëjtë të plotësojnë kërkesat për unitet të dizajnit, të prodhimit ose unitet të përdorimit, ose i takojnë të njëjtit komplet apo kompozicion të gjërave, ose se vetëm një dizajn i pavarur dhe i dallueshëm mund të kërkohet në një aplikacion, mundet, përmes një deklarate, të njoftojë drejtorin gjeneral. Sidoqoftë, një deklaratë e tillë nuk do të ketë vlefshmëri për të drejtën e aplikuesit që të përfshijë dy ose më shumë dizajne industrial në aplikacionin ndërkombëtar sipas nenit 5(4), edhe nëse aplikacioni përcakton palën nënshkruese e cila ka dhënë atë deklaratë.

(2) [Vlefshmëria e deklaratës] Çdo deklaratë e tillë i jep të drejtë Entit të palës nënshkruese e cila e ka lëshuar, të refuzojë vlefshmërinë e regjistrimit ndërkombëtar sipas nenit 12(1) në përputhje me kërkesat e dorëzuara nga ajo palë nënshkruese.

(3) [Taksa të mëtutjeshme për pagesë për pjesë të regjistrimit] Në rastet kur, duke ndjekur njoftimin për refuzim sipas paragrafit (2), regjistrimi ndërkombëtar është i ndarë para Entit me qëllim për t'iu shmangur shkakut për refuzim të cekur në njoftim, ai Ent do të jetë i autorizuar të pranojë taksë në lidhje me çdo aplikacion shtesë ndërkombëtar që do të ishte i nevojshëm

me qëllim për të shmangur arsyen (shkakun) për refuzim.

Neni 14 **Vlefshmëria e regjistrimit ndërkombëtar**

(1) [Vlefshmëria si aplikacion sipas së drejtës së aplikueshme] Regjistrimi ndërkombëtar nga data e regjistrimit ndërkombëtar, do ta ketë të njëjtën vlefshmëri tek secila palë nënshkruese e përcaktuar sikur aplikacioni i dorëzuar në bazë të rregullt për njohjen e mbrojtjes së dizajnit industrial sipas ligjit të palës nënshkruese.

(2) [Vlefshmëria si njohje e mbrojtjes sipas së drejtës së aplikueshme]

(a) Në secilën nga palët nënshkruese të përcaktuara, ku Enti nuk ka lëshuar njoftim për refuzim sipas nenit 12, regjistrimi ndërkombëtar do të ketë vlefshmëri të njëjtë sikur edhe mbrojtja e pranuar për dizajn industrial sipas ligjit të palës nënshkruese, më së voni në datën pas skadimit të periudhës së lejuar për dorëzimin e refuzimit ose kur pala nënshkruese vetëm se ka lëshuar deklaratë sipas Rregullores, më së voni në momentin e specifikuar në atë deklaratë.

(b) Kur Enti i palës nënshkruese të përcaktuar ka dërguar refuzim dhe më pas ka tërhequr atë, pjesërisht apo në tërësi atë refuzim, regjistrimi ndërkombëtar në rastin kur refuzimi është tërhequr (anuluar), do të ketë të njëjtën vlefshmëri për atë palë nënshkruese sikur edhe ajo e pranuar për dizajn industrial sipas ligjit të palës nënshkruese në fjalë, më së voni në datën në të cilën refuzimi është anuluar (tërhequr).

(c) Vlefshmëria e regjistrimit ndërkombëtar sipas këtij paragrafi do të zbatohet në dizajnin industrial, ose në dizajnet që janë lëndë e regjistrimit siç është pranuar nga Byroja ndërkombëtare nga enti i përcaktuar ose, kur është e zbatueshme, siç është plotësuar në procedurën para atij Enti.

(3) [Deklaratë në lidhje me vlefshmërinë nga përcaktimi i palës nënshkruese të aplikuesit] (a) Çdo palë nënshkruese enti i së cilës është ent shqyrtues (ekzaminues) mundet, përmes një deklaratë dërguar deri tek drejtori gjeneral, ta njoftojë se, nëse ajo është palë nënshkruese e aplikuesit, përcaktimi i asaj pale nënshkruese në regjistrimin ndërkombëtar të mos jetë i vlefshëm.

(b) Kur pala nënshkruese e cila ka dërguar deklaratë sipas pikës (a) është potencuar në aplikacionin ndërkombëtar edhe si palë nënshkruese e aplikuesit edhe si palë nënshkruese e përcaktuar, Byroja ndërkombëtare do të injorojë përcaktimin e asaj pale nënshkruese.

Neni 15 **Shfuqizimi**

(1) [Kërkesat për mundësi mbrojtjeje] (a) Anulimi i vlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar nga autoritetet kompetente të palës nënshkruese të përcaktuar, pjesërisht ose në tërësi, në territorin e asaj pale, nuk mund të shqiptohet pa mundësinë që bartësi, në një kohë mirë të përcaktuar, të mbrojë të drejtat e tij.

(2) [Njoftim për shfuqizim (anulim)] Enti i palës nënshkruese në territorin e së cilës është shfuqizuar (anuluar) vlefshmëria e regjistrimit ndërkombëtar, për këtë anulim e njofton Byronë ndërkombëtare.

Neni 16

Regjistrimi i ndryshimeve dhe çështje të tjera në lidhje me regjistrimet ndërkombëtare

(1) [Regjistrimi i ndryshimeve dhe çështje tjera] Byroja ndërkombëtare, siç është përshkruar, do të kryej regjistrimin në Regjistrin ndërkombëtar të:

- (i) çdo ndryshimi të pronësisë së regjistrimit ndërkombëtar, në lidhje me ndonjë apo me të gjitha palët nënshkruese dhe në lidhje me ndonjë ose me të gjithë dizajnët industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar, duke parashikuar që pronari i ri është i autorizuar të dorëzojë aplikacion ndërkombëtar sipas nenit 3.
- (ii) çdo ndryshim në emrin dhe adresën e bartësit,
- (iii) çdo autorizim të përfaqësuesit të aplikuesit apo të bartësit dhe çdo fakt tjetër relevant në lidhje me atë përfaqësues;
- (iv) çdo tërheqje (heqje dorë) nga bartësi i regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me ndonjë ose me të gjitha palët nënshkruese të përcaktuara,
- (v) çdo kufizim nga bartësi i regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me ndonjë ose me të gjithë palët nënshkruese për një ose për të gjithë dizajnët industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar,
- (vi) çdo shfuqizim (anulim) nga organet e autorizuara të palës nënshkruese të përcaktuar që është në territorin e asaj pale nënshkruese, të regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me ndonjë ose me të gjithë dizajnët industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar,
- (vii) çdo fakt tjetër relevant, të cekur në Rregullore, në lidhje me të drejtat e ndonjë apo të gjithë dizajnëve industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar.

(2) [Vlefshmëria e regjistrimit (evidentimit) në Regjistrin ndërkombëtar] Çdo regjistrim sipas pikave (i), (ii), (v), (vi) dhe (vii) nga paragrafi (1) do të ketë vlefshmërinë e njëjtë sikur të jetë regjistruar në regjistrin e Enteve të çdo pale nënshkruese për të cilën bëhet fjalë, përveç nëse Pala nënshkruese, përmes deklaratës, e njofton drejtorin gjeneral se regjistrimi i cekur në pikën (i) të paragrafit (1) nuk ka vlefshmëri në atë palë nënshkruese derisa Enti i asaj pale nënshkruese të mos pranojë deklaratat ose dokumentet që janë të cekura në atë deklaratë.

(3) [Taksa] Çdo regjistrim sipas paragrafit (1) mund të jetë lëndë e pagesës së taksave.

(4) [Shpallja] Byroja ndërkombëtare do të shpall njoftim në lidhje me çdo regjistrim të bërë sipas paragrafit (1). Ajo do të dërgojë kopje nga shpallja deri tek secili Ent i palës nënshkruese për të cilën bëhet fjalë.

Neni 17

Periudha fillestare dhe rinovimi (ripërtëritja) e regjistrimit ndërkombëtar dhe kohëzgjatja e mbrojtjes

(1) [Fillimi i regjistrimit ndërkombëtar] Regjistrimi ndërkombëtar do të ketë vlefshmëri në pesë vitet e para të llogaritur nga data e regjistrimit ndërkombëtar.

(2) [Rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar] Regjistrimi ndërkombëtar mund të rinovohet (ripërtërihet) për pesë vite tjera shtesë, në pajtim me procedurën e paraparë dhe pagesën e taksave të përcaktuara.

(3) [Kohëzgjatja e mbrojtjes në Palën nënshkruese të përcaktuar] (a) Në rastin kur regjistrimi ndërkombëtar është rinovuar për periudhë shtesë pesë vjeçare dhe në rast të zbatimit të nënparagrafit (b), kohëzgjatja e mbrojtjes në çdo palë nënshkruese të përcaktuar do të jetë 15 vite duke llogaritur nga data e regjistrimit ndërkombëtar.

(b) Kur me ligj të palës nënshkruese të përcaktuar parashihet që kohëzgjatja e mbrojtjes së dizajnit industrial të jetë më shumë se 15 vite sipas atij ligji, kohëzgjatja e mbrojtjes, në rast të ripërtëritjes (rinovimit) të regjistrimit ndërkombëtar do të jetë i njëjti sikur ajo që është parashikuar me ligjin e asaj pale nënshkruese.

(c) Çdo palë nënshkruese, përmes një deklarate do të njoftojë drejtorin gjeneral për kohëzgjatjen maksimale të mbrojtjes të paraparë sipas ligjit të saj.

(4) [Mundësi për rinovim (ripërtëritje) të kufizuar] Rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar mund të jetë në vlefshmëri për një ose për të gjitha palët nënshkruese të përcaktuara dhe për një ose për të gjithë dizajnet industrial që janë lëndë e atij regjistrimi ndërkombëtar.

(5) [Regjistrimi dhe shpallja e ripërtëritjes (rinovimit)] Byroja ndërkombëtare do të regjistrojë ripërtëritjet në regjistrin ndërkombëtar dhe për këtë do të bëjë shpallje. Ajo do të dërgojë kopje nga shpallja e atij rinovimi deri tek Enti i çdo pale nënshkruese në fjalë.

Neni 18
Informacione në lidhje me regjistrimet e shpallura ndërkombëtare

(1) [Qasje deri tek informacionet] Byroja ndërkombëtare, çdo personi që ka dërguar kërkesë dhe pas pranimit të taksës së paraparë, do t'i dërgojë ekstrakt nga regjistri ndërkombëtar ose informacion që ka të bëjë me përmbajtjen e Regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me çdo regjistrim të shpallur ndërkombëtar.

(2) [Përrjashtim nga legalizimi] Ekstraktet nga regjistri ndërkombëtar të lëshuara nga Byroja ndërkombëtare do të përjashtohen nga detyrimi për t'u legalizuar në ndonjërin nga palët nënshkruese.

KAPITULLI II
DISPOZITAT ADMINISTRATIVE

Neni 19
Enti i përbashkët për disa shtete

(1) [Njoftimi për Ent të përbashkët] Në qoftë se disa shtete që kanë për qëllim të bëhen anëtare të këtij Akti, ose nëse disa shtete të këtij Akti janë pajtuar, unifikimi i legjislacionit të tyre vendor për dizajnin industrial, ata mund të njoftojnë drejtorin gjeneral:

- (i) se Enti i përbashkët do të jetë zëvendësim i Entit nacional për secilin prej tyre, dhe
- (ii) se territoret e tyre në tërësi, mbi të cilët zbatohet legjislacioni i unifikuar, do të konsiderohen si një Palë nënshkruese për qëllime të zbatimit të neneve 1, 3 deri 18 dhe 31 të këtij Akti.

(2) [Koha për përgatitjen e njoftimit] Njoftimi që është lëndë e paragrafit (1) do të përpilohet:

- (i) Në rastin e shteteve që kanë për qëllim të bëhen pjesë e këtij Akti, në kohën e deponimit të instrumenteve të cekura në nenin 27(2);
- (ii) Në rastin e shteteve që janë pjesë e këtij akti, në çdo kohë pas unifikimit të legjislacionit të tyre vendor.

(3) [Data e hyrjes në fuqi të njoftimit] Njoftimi i cekur në paragrafët (1) dhe (2) do të hyjë në fuqi:

- (i) Në rastin e shteteve që kanë për qëllim të bëhen pjesë e këtij akti, në kohën kur ato palë janë të obliguara me këtë akt;
- (ii) Në rastin e shteteve pjesë e këtij Akti, tre muaj pas datës së

komunikimit të drejtorit gjeneral me palët nënshkruese ose në ndonjë datë të mëvonshme të potencuar në njoftim.

Neni 20 **Anëtarësimi në Unionin e Hagës**

Palët nënshkruese do të bëhen anëtare të të njëjtit Union si edhe shtetet pjesë e Aktit të vitit 1934 dhe Aktit të vitit 1960.

Neni 21 **Kuvendi**

(1) [Përbërja] (a) Palët nënshkruese do të bëhen anëtare e Kuvendit të njëjtë të shteteve të përshkruara me nenin 2 nga Akti shtesë i vitit 1967.

(b) Çdo anëtar i Kuvendit do të përfaqësohet në Kuvend nga një delegat, të cilit mund t'i ndihmojnë edhe delegatë të tjerë, këshilltarë dhe ekspertë, dhe çdo delegat mund të përfaqësojë vetëm një Palë nënshkruese.

(c) Anëtarët e Unionit që nuk janë pjesë e Kuvendit do të ftohen në mbledhjet e Kuvendit si vëzhgues.

(2) [Detyrat] (a) Kuvendi do të:

- (i) Punojë me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit dhe zbatimin e këtij Akti;
- (ii) Plotësojë ato të drejta dhe çështje që në veçanti kanë të bëjnë me atë ose që janë të cekura në këtë Akt ose në Aktin shtesë të vitit 1967;
- (iii) I jap udhëzime drejtorit gjeneral që kanë të bëjnë me përgatitjet e konferencave për rishikime dhe do të vendosë për thirrjen e atyre konferencave;
- (iv) Plotësojë Rregulloren;
- (v) Shqyrtojë dhe do të përmirësojë raportet e drejtorit gjeneral në lidhje me Unionin, dhe do t'i ofrojë drejtorit gjeneral të gjitha instruksionet e nevojshme në lidhje me çështjet që janë në kompetencë të Unionit;
- (vi) Përcaktojë programin dhe do të miratojë buxhetin dyvjeçar të Unionit si dhe do të miratoj llogaritë përfundimtare;
- (vii) Miratojë rregulloret financiare të Unionit;
- (viii) Themelojë komitetet dhe grupe punuese me qëllim që të arrihen qëllimet e Unionit
- (ix) Përcaktojë se cilat shtete, organizata ndërqeveritare dhe organizata joqeveritare, në pajtim me paragrafin (1)(c), do të ftohen në mbledhje (takime) si vëzhgues;
- (x) Ndërmarrë të gjitha aktivitetet e domosdoshme për të përmbushur qëllimet e Unionit dhe do të kryej të gjitha

funksionet që i janë përcaktuar me këtë Akt.

(b) lidhje me çështjet që gjithashtu janë në interes të Unioneve të tjera të administruara nga Organizata, Kuvendi do të sjellë vendime pas këshillave të marra nga Komiteti koordinues i Organizatës.

(3) [Kuorumi] (a) Gjysma e anëtarëve të Kuvendit që janë shtete dhe kanë të drejtë vote për çështje të caktuara e përbëjnë kuorumin për qëllime votimi mbi atë çështje të caktuar.

(b) Duke mos injoruar dispozitat nga nënparagrafi (a), nëse në ndonjë seancë numri i anëtarëve të Kuvendit që janë shtete dhe kanë të drejtë të votojnë për çështje të caktuara dhe që janë të përfaqësuara, është më i vogël se gjysma, por i barabartë ose më i madh se një e treta e anëtarëve të Kuvendit që janë shtete dhe kanë të drejtë vote në çështje të caktuara, Kuvendi mund të sjell vendime, por, me përjashtim të vendimeve që kanë të bëjnë me vetë procedurën e tij, të gjitha vendimet e tilla do të hyjnë në fuqi vetëm nëse janë plotësuar kushtet që janë potencuar këtu. Byroja ndërkombëtare do t'i dërgojë vendimet në fjalë deri tek anëtarët e Kuvendit që janë shtetet që kanë të drejtë vote për çështje të caktuara dhe që nuk kanë qenë të pranishme, dhe do t'i ftojë ato të japin votën e tyre në formë të shkruar ose të abstenojnë në periudhë prej tre muajve nga data e komunikimit. Në qoftë se, pas kalimit të kësaj periudhe, numri i anëtarëve që kanë dërguar votën e tyre ose që kanë abstenuar arrin numrin që nevojitej për të arritur kuorumin e sesionit në fjalë, ato vendime do të hyjnë në fuqi duke parashikuar që shumica e kërkuar ka ekzistuar në momentin e dhënë.

(4) [Sjellja e vendimeve në Kuvend] (a) Kuvendi do të sjellë vendimet e tij me konsensus.

(b) Kur vendimi nuk mund të silllet me konsensus, vendimi për atë çështje do të silllet përmes votimit: Në këtë rast:

- (i) Çdo palë nënshkruese që është shtet ka një votë dhe ajo do të votojë vetëm në emër të vet, dhe
- (ii) Çdo palë nënshkruese që është organizatë ndërqeveritare mund të votojë në vend të shteteve të saj anëtare, me numër të votave të barabartë me numrin e shteteve anëtare që janë pjesë e këtij Akti dhe asnjë nga organizatat ndërqeveritare nuk do të marrë pjesë në votim nëse ndonjë nga shtetet e shfrytëzon të drejtën për të votuar dhe e kundërta.

(c) Për çështje që kanë të bëjnë vetëm me shtetet që janë të obliguara me nenin 2 nga Akti shtesë i vitit 1967, palët nënshkruese që nuk janë të obliguara me atë nen nuk do të kenë të drejtë vote, ndërsa për çështjet që kanë të bëjnë me palët nënshkruese vetëm këta të dytë do të kenë të drejtë të votojnë.

(5) [Shumica] (a) Lëndë e nenit 24 (2) dhe 26 (2), vendimet e Kuvendit sillen me shumicë prej dy të tretave të votave.

(b) Abstenimi nuk llogaritet si votim.

(6) [Seanca] (a) Kuvendi do të mbledhet njëherë në çdo vit të dytë kalendarik në seanca të rregullta në thirrje të drejtorit gjeneral dhe, nëse nuk paraqiten kushte (situata) të jashtëzakonshme, në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtin vend si edhe Kuvendi i përgjithshëm i Organizatës.

(b) Kuvendi do të mbledhet në seanca të jashtëzakonshme në thirrje të Drejtorit gjeneral, ose me kërkesë të çerekut të anëtarëve të Kuvendit ose me iniciativë të Drejtorit gjeneral.

(c) Rendi i ditës për çdo seancë përgatitet nga Drejtori gjeneral.

(7) [Rregullat e procedurës] Kuvendi do të miratojë rregulla të veta të procedurës.

Neni 22 **Byroja ndërkombëtare**

(1) [Detyra administrative] (a) Regjistrimi ndërkombëtar dhe aktivitetet e ndërlidhura, si edhe çështjet tjera administrative në lidhje me unionin do të kryhen nga Byroja ndërkombëtare.

(b) Në veçanti, Byroja ndërkombëtare do të përgatisë takimet dhe do të shërbejë si sekretariat i Kuvendit dhe komiteteve të tjera të ekspertëve dhe grupeve punuese që mund të formohen nga Kuvendi.

(2) [Drejtori gjeneral] Drejtori gjeneral do të jetë shef ekzekutiv i Unionit dhe do ta përfaqësojë Unionin.

(3) [Takime që nuk janë seanca të Kuvendit] Drejtori gjeneral do t'i thërrasë të gjitha komitetet dhe grupet punuese të Kuvendit dhe të gjitha takimet që kanë të bëjnë me punën e Unionit.

(4) [Roli i Byrosë ndërkombëtare në Kuvend dhe takimet e tjera]

(a) Drejtori gjeneral dhe personat e emëruar nga drejtori gjeneral do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në të gjitha takimet e Kuvendit, të komiteteve dhe grupeve punuese të formuara nga Kuvendi, dhe në çdo takim tjetër të iniciuar nga drejtori gjeneral, e në lidhje me Unionin.

(b) Drejtori gjeneral ose anëtari nga stafi i autorizuar nga drejtori gjeneral do të jetë ex officio, sekretar i Kuvendit, komiteteve, grupeve punuese dhe takimeve të tjera sipas pikës (a).

(5) [Konferenca] (a) Byroja ndërkombëtare, sipas udhëzimeve të Kuvendit, do të kryej përgatitjet për çdo konferencë revizore (rishikuese).

(b) Byroja ndërkombëtare mund të konsultohet me organizata ndërqeveritare dhe organizata ndërkombëtare e joqeveritare në lidhje me përgatitjet në fjalë.

(c) Drejtori gjeneral dhe personat e emëruar nga ai do të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në diskutimet e konferencave revizore.

(6) [Çështje të tjera] Byroja ndërkombëtare do të kryej edhe punë të tjera të përcaktuara, në lidhje me këtë Akt.

Neni 23 **Financat**

(1)[Buxheti] (a) Unioni ka buxhet.

(b) Buxheti i Unionit i përfshin edhe të ardhurat dhe shpenzimet në lidhje me Unionin dhe kontributin e tij drejt buxheteve të përbashkëta të shpenzimeve të unioneve të administruara nga Organizata.

(c) Shpenzimet që nuk i takojnë vetëm Unionit, por një ose më shumë unioneve të administruara nga Organizata, do të konsiderohen si shpenzime të përbashkëta të Unioneve. Pjesa që i takon Unionit në ato shpenzime të përbashkëta është në proporcion me interesin që ka Unioni nga ato.

(2) [Kordinimi me buxhetet e unioneve të tjera] Buxheti i Unionit do të formohet në përputhje me kërkesat për koordinim me buxhetet e unioneve të tjera të administruara nga Organizata.

(3) [Burime për financimin e buxhetit] Buxheti i Unionit do të financohet nga burimet në vijim:

- (i) Taksat nga regjistrimet ndërkombëtare;
- (ii) Ngarkesat (tarifat) për shërbime të tjera të ofruara nga Byroja ndërkombëtare e në lidhje me unionin;
- (iii) Shitjes ose kompensimit të publikimeve të byrosë ndërkombëtare në lidhje me Unionin;
- (iv) Dhurata, trashëgimi dhe subvencione;
- (v) Të ardhura nga qiratë, interesi dhe lloje të tjera të të ardhurave.

(4) [Përcaktimi i taksave dhe tarifave; Niveli i buxhetit] (a) Shuma e taksave të cekura në paragrafin (3)(i) do të përcaktohet nga Kuvendi me propozim të Drejtorit gjeneral. Tarifat e cekura në paragrafin 3(ii) do të formohen nga Drejtori gjeneral dhe do të jenë lëndë e miratimit të Kuvendit në seancën e tij të radhës.

(b) Shuma e taksave të cekura në paragrafin 3(i) do të përcaktohet në atë mënyrë që të hyrat e Unionit nga taksat dhe burimet e tjera do të jenë së paku të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet tjera të Byrosë ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Unionin.

(c) Në qoftë se buxheti nuk miratohet para fillimit të periudhës së re fiskale, ai do të jetë në nivelin e njëjtë si edhe buxheti i vitit paraprak, siç është paraparë

me rregulloret financiare.

(5) [Fond për kapital qarkullues] Unioni do të ketë fond për kapital qarkullues (punues) që përbëhet nga teprica e të hyrave dhe nëse ajo tepricë nuk është e mjaftueshme, nga pagesa të caktuara nga çdo anëtar i Unionit. Nëse fondi është i pamjaftueshëm, Kuvendi vendos për rritjen e tij. Proporcioni dhe kushtet e pagesës do të përcaktohen nga Kuvendi, me propozim të drejtorit gjeneral.

(6) [Avanse nga vendi amë (mikpritës)] (a) Në marrëveshjen për selitë të nënshkruar me vendin në territorin e të cilit Organizata ka selitë e saj do të parashihet që, nëse fondi i kapitalit qarkullues është i pamjaftueshëm, ai shtet do të garantojë avanse. Shuma e atyre avanseve dhe kushtet nën të cilat ato jepen janë lëndë e marrëveshjes së veçantë, në secilin rast, midis vendit dhe Organizatës.

(b) Vendi i cekur në nënparagrafin (a) dhe Organizata, secila nga ana e vet, kanë të drejtë të refuzojnë obligimin për të garantuar avans, përmes njoftimit me shkrim. Refuzimi hyn në fuqi tre vite pas skadimit të vitit në të cilin njoftimi është dërguar.

(7) [Auditimi (Kontrolli) i llogarive] Auditimi i llogarive do të kryhet nga një ose më shume vende anëtare të Unionit ose nga auditorë të jashtëm, siç është parashikuar me rregulloret financiare. Ata do të autorizohen, me marrëveshje të tyre, nga ana e Kuvendit.

Neni 24 ***Rregullore***

(1) [Lënda] Rregullorja mbulon detajet e zbatimit të këtij Akti. Ajo përmban, kryesisht, dispozita që kanë të bëjnë me:

- (i) Çështje për të cilat ky Akt në mënyrë deklarative parashikon të jenë të përshkruara;
- (ii) Detaje të mëtutjeshme që kanë të bëjnë, ose çdo detaj të shfrytëzueshëm në implementimin e dispozitave të këtij Akti.
- (iii) Të gjitha kërkesat, çështjet ose procedurat administrative.

(2) [Plotësimi i dispozitave ekzistuese të Rregullores] (a) Rregullorja mund të specifikojë dispozita të caktuara që mund të plotësohen ose ndryshohen vetëm me unanimitet ose me shumicë prej katër të pestat.

(b) Me qëllim që kërkesa për vendimmarrje me unanimitet ose vendimmarrje me shumicë prej katër të pestat të zbatohet në çdo plotësim të ardhshëm të dispozitave të Rregullores, do të kërkohet vendimmarrje me unanimitet.

(c) Me qëllim që kërkesa për vendimmarrje me unanimitet ose vendimmarrje me shumicë prej katër të pestat të zbatohet në çdo plotësim të ardhshëm të

dispozitave të Rregullores, do të kërkohet shumicë prej katër të pestat për të marrë vendim.

(3) [Konflikt midis këtij Akti dhe Rregullores] Në rast të konfliktit midis dispozitave të këtij akti dhe atyre të Rregullores, i pari (Akti) ka përparësi.

KAPITEULLI III RISHIKIMI DHE PLOTËSIMI

Neni 25 Rishikimi i këtij akti

(1) [Konferencat rishikuese] Ky akt mund të rishikohet në konferencë të palëve nënshkruese.

(2) [Rishikimi ose plotësimi i neneve të caktuara] Nenet 21, 22, 23 dhe 26 mund të plotësohen me konferencë revizore (rishikuese) ose nga Kuvendi në përputhje me dispozitat e përmbajtura në nenin 26.

Neni 26 Plotësimi i neneve ekzistuese nga ana e Kuvendit

(1) [Propozim për plotësime] (a) Propozimet për plotësime nga ana e Kuvendit të neneve 21, 22, 23 dhe të këtij neni mund të iniciohen nga cilado palë nënshkruese ose nga Drejtori gjeneral.

(b) Propozimet e tilla do t'i dërgohen palëve nënshkruese nga drejtori gjeneral më së voni gjashtë muaj para se të mbahet seanca e kuvendit.

(2) [Shumica] Për miratimin e çdo ndryshimi ose plotësimi të neneve të cekura në paragrafin (1) nevojitet shumicë prej tri të katërtave, përveç miratimi i çdo plotësimi dhe ndryshimi të nenit 21 ose të këtij neni, për çka kërkohet shumicë prej katër të pestat.

(3) [Hyrja në fuqi] (a) Përveç në rastet kur zbatohet nënparagrafi (b) çdo plotësim ose ndryshim i neneve të cekura në paragrafin (1) hyn në fuqi një muaj pas njoftimit me shkrim për pranimin e tyre, zbatohet në përputhje me procedurat adekuate konstitutive, pas pranimin nga Drejtori gjeneral nga tri të katërtat e atyre palëve nënshkruese të cilët, në kohën e miratimit të plotësimeve dhe ndryshimeve, kanë qenë anëtare të Kuvendit dhe me të drejtë për votim për atë plotësim apo ndryshim.

(b) Çdo plotësim ose ndryshim i nenit 21 (3) ose (4) ose i këtij nënparagrafi nuk do të hyjë në fuqi, nëse, në afat prej gjashtë muajsh nga miratimi i tyre në

Kuvend, ndonjë nga palët nënshkruese e njofton drejtorin gjeneral se nuk i pranon këto plotësime dhe ndryshime.

(c) Çdo plotësim apo ndryshim që hyn në fuqi sipas dispozitave të këtij paragrafi do të jetë i obligueshëm për të gjitha shtetet dhe organizatat ndërqeveritare që janë palë nënshkruese në kohën kur plotësimet dhe ndryshimet hynë në fuqi, ose që janë bërë palë nënshkruese deri në atë datë.

KAPITULLI IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 27 Të bërit pjesë e këtij Akti

- (1) [Pranueshmëria] Lëndë e paragrafëve (2) dhe (3) dhe nenit 28:
- (i) Çdo shtet anëtarë i Organizatës mund të nënshkruaj dhe të bëhet pjesë e këtij Akti;
 - (ii) Çdo organizatë ndërqeveritare që mirëmban Ent në të cilin mbron dizajn industrial, realizon përmes vlefshmërisë së territorit në të cilin zbatohet marrëveshja për themelimin e asaj organizate ndërqeveritare, mund të nënshkruaj dhe të bëhet pjesë e këtij akti, duke parashikuar se të paktën një shtet nga shtetet anëtare në atë organizatë ndërqeveritare është anëtare e Organizatës dhe duke parashikuar që ai Ent nuk është lëndë e njoftimit sipas nenit 19.
- (2) [Ratifikimi ose Aderimi (Qasja)] Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare e cekur në paragrafin (1) mund të deponojë:
- (i) Instrument për ratifikim, nëse ka nënshkruar këtë Akt, ose
 - (ii) Instrument për aderim (qasje), nëse nuk e ka nënshkruar këtë Akt.
- (3) [Data e hyrjes në fuqi të deponimit] (a) Lëndë e nënparagrafëve (b) dhe (d), data e hyrjes në fuqi të instrumentit të deponuar të ratifikimit ose aderimit do të jetë ajo datë në të cilën është deponuar instrumenti.
- (b) Data e hyrjes në fuqi të instrumentit të deponuar të ratifikimit ose aderimit të ndonjë nga shteteve që mbrojtjen e dizajnit industrial e kryejnë vetëm përmes Entit të themeluar nga organizata ndërqeveritare anëtare e së cilës është ai shtet, do të jetë data në të cilën instrumenti i asaj organizate ndërqeveritare është deponuar, në qoftë se ajo datë është më vonë se data kur instrumenti i shtetit në fjalë është deponuar.
- (c) Data e hyrjes në fuqi të çdo instrumenti të ratifikimit ose aderimit, që përmban ose është shoqëruar me njoftim të cekur në nenin 19, do të jetë ajo datë në të cilën është deponuar instrumenti i fundit i shteteve anëtare të grup-

shteteve që kanë dorëzuar njoftim.

(d) Çdo instrument i ratifikimit ose aderimit të një shteti mund të përmbajë ose të shoqërohet me deklaratë që përmban kushtet për t'u trajtuar sikur të jetë e deponuar, se instrumenti i ndonjë shteti ose organizate ndërqeveritare, ose instrumentet e dy shteteve, ose instrumentet e një shteti dhe një organizate ndërqeveritare, të specifikuara me emër dhe përshtatshmëri për t'u bërë pjesë e këtij Akti, është ose janë, gjithashtu të deponuara. Instrumenti që përmban ose është shoqëruar me deklaratë të tillë do të konsiderohet se është dorëzuar në ditën kur kushti që është potencuar në deklaratë është plotësuar. Sidoqoftë, kur instrumenti i specifikuar në deklaratë përmban, ose është i shoqëruar me deklaratë të këtij lloji, ai instrument do të konsiderohet se është deponuar në ditën kur ai kusht i specifikuar në të deklaratë të mëvonshme, është plotësuar.

(e) Çdo deklaratë e bërë sipas paragrafit (d) mund të tërhiqet në tërësi ose pjesërisht në çdo kohë. Çdo tërheqje e tillë do të hyjë në fuqi në ditën kur njoftimi për tërheqje është pranuar nga Drejtori gjeneral.

Neni 28

Data e hyrjes në fuqi të ratifikimit dhe aderimit (qasjes)

(1) [Instrumentet që duhet të merren parasysh] Për qëllimet e këtij neni vetëm instrumentet e ratifikimit ose aderimit që janë deponuar nga shtetet ose organizatat ndërqeveritare e cekura në nenin 27 (1) dhe që hyjnë në fuqi sipas nenit 27 (3) do të merren parasysh.

(2) [Hyrja në fuqi e këtij Akti] Ky akt hyn në fuqi tre muaj nga momenti kur gjashtë shtete do të deponojnë instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim, duke siguruar që, në përputhje me raportet e fundit vjetore statistikore të grumbulluara nga Byroja ndërkombëtare, të paktën tre nga këto shtete i plotësojnë një nga kushtet në vijim:

- (i) Të paktën 3.000 aplikime për mbrojtjen e dizajnit industrial janë dorëzuar në ose për shtetin për të cilin bëhet fjalë
- (ii) Të paktën 1.000 aplikime për mbrojtjen e dizajnit industrial janë dorëzuar në ose për shtetin për të cilin bëhet fjalë, nga rezidentë të shteteve të tjera

(3) [Hyrja në fuqi e ratifikimit dhe aderimit] (a) Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare që ka deponuar instrumentin e saj për ratifikim ose aderim tre muaj ose më shumë para hyrjes në fuqi të këtij Akti, do të jetë e obliguar me këtë Akt në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Akti.

(b) Çdo shtet ose organizatë ndërqeveritare do të jetë e obliguar me këtë akt tre muaj pas datës në të cilën ka deponuar instrumentin e saj të ratifikimit ose aderimit ose në cilëndo datë të mëvonshme të paraqitur në atë instrument.

Neni 29
Ndalesa për rezerva

Nuk lejohen rezerva për këtë Akt.

Neni 30
Deklarata të bëra nga Palët nënshkruese

(1) [Koha kur mund të bëhen deklaratat] Çdo deklaratë sipas neneve 4(1)(b), 5(2)(a), 7(2), 11(1), 13(1), 14(3), 16(20) ose 17(3)(c) mund të bëhet:

- (i) Në kohën e deponimit të instrumentit të cekur në nenin 27 (2), në të cilin rast do të hyjë në fuqi në datën në të cilën shteti ose organizata ndërqeveritare ka bërë deklaratën me të cilën do të bëhet e obliguar me këtë Akt, ose
- (ii) Pas deponimit të instrumentit të cekur në nenin 27 (2), në të cilin rast do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së pranimit të saj nga Drejtori gjeneral ose në cilëndo datë të mëvonshme të cekur në deklaratë, por, do të zbatohen vetëm për cilindo regjistrim ndërkombëtar data e të cilit është e njëjtë, ose e mëvonshme se data e hyrjes në fuqi të deklaratës.

(2) [Deklaratat nga shtetet që kanë Ent të përbashkët] Pa mos anashkaluar paragrafin (1), çdo deklaratë e cekur në atë paragraf që është bërë nga shteti i cili me ndonjë shtet tjetër ose shtete të tjera, kanë njoftuar drejtorin gjeneral drejtpërdrejt sipas nenit 19(1) për zëvendësim të Entit të përbashkët në vend të enteve të tyre nacionale, do të hyjë në fuqi vetëm nëse ai shtet ose shtete të tjera, bën ose bëjnë deklaratë njoftuese ose deklarata njoftuese.

(3) [Tërheqje nga deklaratat] Çdo deklaratë e cekur në paragrafin (1) mund të tërhiqet në çdo kohë përmes njoftimit të adresuar deri tek Drejtori gjeneral. Tërheqja e tillë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën drejtori gjeneral e ka pranuar njoftimin ose në cilëndo datë të mëvonshme të potencuar në njoftim. Në rast të njoftimit të bërë sipas nenit 7(2), tërheqja nuk do të ndikojë në aplikacionet ndërkombëtare të dorëzuara para se të hyjë në fuqi tërheqja në fjalë.

Neni 31
Zbatimi i Akteve të vitit 1934 dhe 1960

(1) [Marrëdhëniet midis shteteve anëtare të këtij Akti dhe të Akteve të vitit 1934 ose 1960] Ky akt i vetëm do të zbatohet në të njëjtën mënyrë sikur

marrëdhëniet e shteteve anëtare të të dy akteve, këtij akti dhe akteve të vitit 1934 ose 1960. Sidoqoftë, shtetet e tilla, në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella do të zbatojnë Aktin e vitit 1934 ose Aktin e vitit 1960, që mund të jetë rasti, për dizajnet industrial të deponuara te Byroja ndërkombëtare para datës në të cilën ky akt të ketë qenë i aplikueshëm në lidhje me marrëdhëniet e tyre të ndërsjella.

(2) [Marrëdhëniet midis shteteve anëtare të këtij Akti dhe akteve të vitit 1934 dhe 1960 dhe shtetet anëtare të Akteve të vitit 1934 ose 1960 që nuk janë anëtarë të këtij Akti] (a) Çdo shtet që është anëtar i këtij Akti dhe Akti të vitit 1934, do të vazhdojë të zbatojë Aktin e vitit 1934 në marrëdhëniet e tij me shtetet që janë anëtare të Aktit të vitit 1934, ndërsa nuk janë anëtarë të Aktit të vitit 1960 ose të këtij Akti.

(b) Çdo shtet që është anëtar i këtij Akti dhe Aktit të vitit 1960 do të vazhdojë të zbatojë Aktin e vitit 1960 në marrëdhëniet me shtetet që janë anëtarë të Aktit të vitit 1960, ndërsa nuk janë anëtarë të këtij Akti.

Neni 32

Tërheqja nga ky akt (Prishja e marrëveshjes)

(1) [Njoftimi] Çdo palë nënshkruese mund të heq dorë nga ky akt përmes njoftimit të adresuar deri tek Drejtori gjeneral.

(2) [Hyrja në fuqi] Anulimi (tërheqja) do të hyjë në fuqi një vit pas datës në të cilën drejtori gjeneral ka pranuar njoftimin ose në cilën do datë të mëvonshme të potencuar në njoftim. Kjo nuk do të ndikojë në zbatimin e këtij Akti mbi cilindo aplikacion ndërkombëtar që është në procedurë ose cilindo regjistrim ndërkombëtar që është në fuqi për palën nënshkruese që heq dorë nga Akti (tërhiqet) në kohën kur tërheqja hyn në fuqi.

Neni 33

Gjuhët e këtij Akti; Nënshkrimi

(1) [Tekstet origjinale; Tekstet zyrtare] (a) Ky akt do të nënshkruhet në një kopje origjinale në gjuhën angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle dhe të gjithë tekstet do të jenë autentik.

(b) Tekstet zyrtare do të krijohen nga Drejtori gjeneral, pas konsultimeve me qeveritë e interesuara, në gjuhë të tjera që do të përcaktohen nga Kuvendi.

(2) [Kufizim kohor për nënshkrim] Ky akt do të mbetet i hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës, një vit pas miratimit të tij.

Neni 34
Depozitar

Drejtori gjeneral do të jetë depozitar (garantues) i këtij Akti.

RREGULLORE

Sipas Aktit të Gjenevës të vitit 1999, Aktit të vitit 1960 dhe Aktit të vitit 1934 të Marrëveshjes së Hagës (në fuqi nga 1 prilli i vitit 2004)

PËRMBAJTJA

Kapitulli 1: Dispozitat e përgjithshme

- Rregulli 1: Definicione
- Rregulli 2: Komunikimi me Byronë ndërkombëtare
- Rregulli 3: Përfaqësimi para Byrosë ndërkombëtare
- Rregulli 4: Përlogaritja e kufizimeve kohore
- Rregulli 5: Parregullsi në shërbimet postare dhe në dërgesat
- Rregulli 6: Gjuhët

Kapitulli 2: Aplikacioni ndërkombëtar dhe regjistrimi ndërkombëtar

- Rregulli 7: Kërkesat lidhur me aplikacionin ndërkombëtar
- Rregulli 8: Kërkesa të veçanta që kanë të bëjnë me aplikuesin
- Rregulli 9: Riprodhimet e dizajnit industrial
- Rregulli 10: Mostra të dizajnit industrial kur kërkohet prolongim i shpalljes
- Rregulli 11: Identiteti i kreatorit (krijuesit); përshkrimi; kërkesa
- Rregulli 12: Taksat në lidhje me aplikacionin ndërkombëtar
- Rregulli 13: Aplikacioni ndërkombëtar i dorëzuar përmes Entit
- Rregulli 14: Shqyrtimi (Ekzaminimi) nga Byroja ndërkombëtare
- Rregulli 15: Regjistrimi i dizajnit industrial në Regjistrin ndërkombëtar
- Rregulli 16: Prolongimi i shpalljes
- Rregulli 17: Shpallja e regjistrimit ndërkombëtar

Kapitulli 3: Refuzime dhe anulime

- Rregulli 18: Njoftimi për refuzim
- Rregulli 19: Refuzim jo i rregullt
- Rregulli 20: Shfuqizimi (Anulimi)

Kapitulli 4: Ndryshime dhe korrigjime

- Rregulli 21: Regjistrimi i ndryshimeve
- Rregulli 22: Korrigjime në Regjistrin ndërkombëtar

Kapitulli 5: Rinovimi (Ripërtëritja)

- Rregulli 23: Njoftim jozyrtar për skadim
- Rregulli 24: Detaje në lidhje me rinovimin
- Rregulli 25: Regjistrimi i rinovimit, Aktvendim

Kapitulli 6: Buletini

Rregulli 26: Buletini

Kapitulli 7: Taksa

Rregulli 27: Shumat dhe pagesat e taksave

Rregulli 28: Valuta për pagesë

Rregulli 29: Kreditim i taksave nga llogaritë e Palëve nënshkruese në fjalë

Kapitulli 8: Aplikacione ndërkombëtare të kryera në tërësi ose pjesërisht sipas Aktit të vitit 1934 dhe regjistrimet ndërkombëtare që dalin nga aplikacioni i tillë

Rregulli 30: Zbatimi i rregullave për regjistrimin ndërkombëtar, në tërësi sipas aktit të vitit 1934 dhe regjistrimet ndërkombëtare që dalin nga aplikacioni i tillë

Rregulli 31: Zbatimi i rregullave për regjistrimin ndërkombëtar, pjesërisht sipas Aktit të vitit 1934 dhe regjistrimet ndërkombëtare që dalin nga aplikacioni i tillë

Kapitulli 9: Të ndryshme

Rregulli 32: Ekstrakte, kopje dhe informacione në lidhje me regjistrimet e shpallura ndërkombëtare

Rregulli 33: Plotësimi i Rregullave ekzistuese

Rregulli 34: Instruksione administrative

Rregulli 35: Deklarata të bëra nga Palët nënshkruese të Aktit të vitit 1999

Rregulli 36: Deklarata të bëra nga Palët nënshkruese të Aktit të vitit 1960

KAPITULLI 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Rregulli 1

Definicione

- (1) [Shprehje të shkurtuara] Për qëllimet e kësaj Rregullore,
- (i) “Akti i 1999” nënkupton Aktin, nga marrëveshja e Hagës, të nënshkruar në Gjenevë më 2 korrik të vitit 1999;
 - (ii) “Akti i 1960” nënkupton Aktin, nga Marrëveshja e Hagës, të nënshkruar më 28 nëntor të vitit 1960 në Hagë,
 - (iii) “Akti i 1934” ka të bëjë me Aktin e Marrëveshjes së Hagës, të nënshkruar në Londër më 2 qershor të vitit 1934.
 - (iv) Shprehja që përdoret në këtë rregullore dhe që thirret në nenin 1 të Aktit të vitit 1999 e ka të njëjtin kuptim si edhe në vetë Aktin.
 - (v) Me “Udhëzime administrative” nënkuptohen udhëzimet administrative të cekura në Rregullin 34;
 - (vi) “Komunikimi” nënkupton çdo aplikacion ndërkombëtar ose çdo kërkesë, deklaratë, ftesë, njoftim ose informacion që ka të bëjë me, ose që e shoqëron aplikacionin ndërkombëtar ose regjistrimin ndërkombëtar, që është adresuar në Byronë e shtetit – palë nënshkruese; deri te Byroja ndërkombëtare, deri te aplikuesi ose bartësi dhe që është dorëzuar në mënyrë të lejuar me këtë Rregullore ose me udhëzimet administrative
 - (vii) “formular zyrtar” nënkupton formular i krijuar nga Byroja ndërkombëtare dhe çdo formular tjetër që ka të njëjtën përmbajtje dhe format të njëjtë
 - (viii) “Klasifikimi ndërkombëtar” nënkupton klasifikimin e themeluar sipas Marrëveshjes së Lokarnos për themelimin e Klasifikimit ndërkombëtar për dizajn industrial;
 - (ix) “taksë e caktuar” ka të bëjë me çdo taksë të aplikueshme të ekspozuar në skemën e taksave
 - (x) “Buletini” ka të bëjë me buletinin periodik në të cilin Byroja ndërkombëtare i realizon publikimet e parapara me Aktin e 1999, Aktin e 1960, Aktin e 1934 ose me këtë Rregullore, pa marrë parasysh mediumin që përdoret;
 - (xi) “Palë nënshkruese e përcaktuar sipas Aktit të 1999” nënkupton palën nënshkruese të përcaktuar mbi të cilën Akti i 1999 është i aplikueshëm, ose si akt i vetëm i përbashkët në të cilën janë të obliguar pala nënshkruese e aplikuesit dhe pala nënshkruese e përcaktuar, ose sipas mënyrës nga neni 31(1), fjalia e parë e Aktit të 1999.
 - (xii) “Palë nënshkruese e përcaktuar sipas Aktit të 1960” nënkupton palën nënshkruese të përcaktuar në të cilën Akti i 1960 është i aplikueshëm, ose si akt i vetëm i përbashkët në të cilin janë të

obliguar pala e njëjtë nënshkruese dhe Shteti i prejardhjes sipas nenit 2 të Aktit të 1960, ose në mënyrën sipas nenit 31(1), fjalia e parë e Aktit të 1960.

- (xiii) “Palë nënshkruese e përcaktuar sipas Aktit të 1934” nënkupton palën nënshkruese të përcaktuar në të cilën Akti i 1934 është i aplikueshëm, si akt i vetëm i përbashkët në të cilin ajo palë nënshkruese e përcaktuar dhe pala nënshkruese e definuar me nenin 1 të Aktit të vitit 1934 janë të obliguara;
- (xiv) “Aplikacioni ndërkombëtar që i takon ekskluzivisht nën Aktin e 1999” nënkupton aplikacionin ndërkombëtar në raport me të cilin të gjithë palët nënshkruese janë palë nënshkruese të përcaktuara sipas aktit të 1999.
- (xv) “Aplikacioni ndërkombëtar që i takon ekskluzivisht nën Aktin e 1960” nënkupton aplikacionin ndërkombëtar në raport me të cilin të gjithë palët nënshkruese janë palë nënshkruese të përcaktuara sipas aktit të 1960.
- (xvi) “Aplikacioni ndërkombëtar që i takon ekskluzivisht nën Aktin e 1934” nënkupton aplikacionin ndërkombëtar në raport me të cilin të gjithë palët nënshkruese janë palë nënshkruese të përcaktuara sipas aktit të 1934.
“Aplikacioni ndërkombëtar që bie nën dy aktet e 1999 dhe të 1960” nënkupton aplikacionin ndërkombëtar në lidhje me të cilin
 - Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1999;
 - Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1960 dhe
 - Asnjë nga palët nënshkruese nuk është përcaktuar sipas aktit të vitit 1934,
- (xvii) "Aplikacioni ndërkombëtar që bie nën dy aktet e 1999 dhe 1934" nënkupton aplikacionin ndërkombëtar në lidhje me të cilin
 - Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1999;
 - Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1934 dhe
 - Asnjë nga palët nënshkruese nuk është përcaktuar sipas aktit të vitit 1960,
- (xviii) (xix) "Aplikacioni ndërkombëtar që bie nën dy aktet e 1960 dhe 1934" nënkupton aplikacionin ndërkombëtar në lidhje me të cilin
 - Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1960;
 - Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1934 dhe

- Asnjë nga palët nënshkruese nuk është përcaktuar sipas aktit të vitit 1999,
- (xix) "Aplikacioni ndërkombëtar që bie nën aktin e 1999, aktin e 1960 dhe nën aktin e 1934" nënkupton aplikacionin ndërkombëtar në lidhje me të cilin
- Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1999;
 - Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1960 dhe
 - Të paktën një palë nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1934.
- (3) [Korrespondenca midis disa shprehjeve të përdorura në Aktin e 1999, 1960 dhe Aktin e 1934] Për qëllimet e kësaj Rregullore,
- (i) referenca "aplikacioni ndërkombëtar" ose "regjistrimi ndërkombëtar" do të nënkuptojë se përfshinë edhe (aty ku është adekuate) referencën "depozita ndërkombëtare" siç është e cekur në Aktin e 1960 dhe Aktin e 1934;
 - (ii) referenca "aplikues" ose "bartës" do të nënkuptojë që përfshinë (aty ku është adekuate) edhe referencën "depozitor" respektivisht "pronar", si është e cekur në Aktin e 1960 dhe Aktin e 1934.
 - (iii) Referenca "Pala nënshkruese" do të nënkuptojë se përfshin (aty ku është adekuate) referenca për shtetet nënshkruese të Aktit të 1960 ose shtetet nënshkruese të Aktit të 1934,
 - (iv) Referenca "Pala nënshkruese Enti i së cilës kryen ekzaminime" do të nënkuptojë se përfshin (aty ku është adekuate) edhe referenca për "Shteti që kryen ekzaminime për inovacione" siç është definuar në nenin 2 të Aktit të 1960.
 - (v) Referenca "taksë individuale për përcaktim" do të nënkuptojë se përfshi (aty ku është adekuate) referencë për taksën e cekur në nenin 15(1)2(b) të Aktit të 1960;
 - (vi) Referenca "ripërtëritje" do të nënkuptojë se përfshi (aty ku është adekuate) edhe referencë për "vazhdim" siç është cekur në Aktin e 1934.

Rregulli 2

Komunikimi me Byronë ndërkombëtare

Komunikimi i adresuar deri te Byroja ndërkombëtare do të realizohet siç është e parashikuar me udhëzimet administrative.

Rregulli 3 **Përfaqësimi para Byrosë ndërkombëtare**

(1) (Përfaqësues; numri i përfaqësuesve) (a) Aplikuesi ose bartësi mund të kenë përfaqësues para Byrosë ndërkombëtare.

(b) Vetëm një përfaqësues mund të caktohet në lidhje me aplikacionin e caktuar ndërkombëtar apo me regjistrimin ndërkombëtar. Kur emërimi (autorizimi) tregon disa përfaqësues, vetëm ai që është i potencuar si i pari do të konsiderohet për përfaqësues dhe do të regjistrohet si i tillë.

(c) Kur partneriteti ose firma e përbërë nga avokatë ose agjentë të patentave ose agjentë të markave janë cekur si përfaqësues në Byronë ndërkombëtare, ata do të konsiderohen si një përfaqësues.

(2) (Autorizimi i përfaqësuesit) (a) Emërimi (autorizimi) i përfaqësuesit mund të bëhet ë aplikacionin ndërkombëtar, duke paraparë se aplikacioni është nënshkruar nga aplikuesi.

(b) Emërimi i përfaqësuesve mund gjithashtu të kryhet në komunikim të ndarë që mund të ketë lidhje me një ose më shumë aplikacione ndërkombëtare të specifikuara ose regjistrime ndërkombëtare të të njëjtit aplikuesi ose bartës. Komunikimi në fjalë do të nënshkruhet nga aplikuesi ose bartësi.

(c) Kur Byroja ndërkombëtare ka konstatuar se emërimi i përfaqësuesit është me gabime, ajo do ta njoftojë menjëherë aplikuesin ose bartësin dhe përfaqësuesin e pretenduar.

(3) (Regjistrimi i njoftimit për autorizimin e përfaqësuesit; data e hyrjes në fuqi të autorizimit)

(a) Kur Byroja ndërkombëtare do të konstatojë se autorizimi i përfaqësuesit i plotëson kërkesat, ajo do ta regjistrojë faktin se aplikuesi ose bartësi ka përfaqësues, njëjtë sikur edhe emrin dhe adresën e përfaqësuesit në Regjistrin ndërkombëtar. Në këtë rast për datë të hyrjes në fuqi të autorizimit do të konsiderohet data në të cilën Byroja ndërkombëtare ka pranuar aplikacionin ndërkombëtar ose komunikimin e veçantë në të cilin është autorizuar përfaqësuesi.

(b) Byroja ndërkombëtare do të njoftojë lidhur me regjistrimin e bërë sipas nënparagrafit (a) edhe aplikuesin ose bartësin edhe përfaqësuesin.

(4) (Rëndësia e autorizimit të përfaqësuesit) (a) Përveç nëse Rregullorja nuk parasheh në mënyrë të qartë ndryshe, nënshkrimi i përfaqësuesit të regjistruar sipas paragrafit (3)(a) do të zëvendësojë nënshkrimin e aplikuesit ose bartësit.

(b) Përveç kur Rregullorja qartë kërkon që komunikimi të adresohet edhe tek aplikuesi ose bartësi edhe tek përfaqësuesi, Byroja ndërkombëtare do ta adresojë deri tek përfaqësuesi i regjistruar sipas paragrafit (3)(a) komunikimin e tërësishëm, i cili, në rast të mungesës së përfaqësuesit, do duhej t'i dërgohej aplikuesit ose bartësit; komunikacioni i plotë, i adresuar kështu deri te përfaqësuesi në fjalë do të ketë vlefshmërinë e njëjtë sikur edhe të jetë

adresuar deri tek aplikuesi ose bartësi.

(c) Komunikimi i tërësishëm i adresuar deri te Byroja ndërkombëtare nga ana e përfaqësuesit të regjistruar sipas paragrafit (3) do ta ketë të njëjtën vlefshmëri sikur të jetë adresuar deri te Byroja nga ana e aplikuesit ose bartësit.

(5) (Tërheqja nga regjistrimi; data e hyrjes në fuqi e tërheqjes) (a) Çdo regjistrim sipas paragrafit (3)(a) do të revokohet kur kërkohet revokim në komunikim të nënshkruar nga aplikuesi, bartësi ose përfaqësuesi. Regjistrimi do të revokohet ex officio nga Byroja ndërkombëtare kur regjistrohet përfaqësues i ri ose kur regjistrohet ndryshim në pronësi dhe kur nuk është përcaktuar përfaqësues i ri nga bartësi i ri i regjistrimit ndërkombëtar.

(b) Revokimi do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Byroja ndërkombëtare do të pranojë komunikatën korrespondente.

(c) Byroja ndërkombëtare do të njoftojë për revokimin dhe për datën e hyrjes në fuqi të të njëjtës përfaqësuesin, emërimi i të cilit është revokuar, si dhe aplikuesin dhe bartësin.

Rregulli 4 **Përlllogaritja e kufizimeve kohore**

(1) (Periudha të shprehura në vite) Çdo periudhë e shprehur në vite do të skadojë në vitin pasues relevant, në muajin që ka të njëjtin emër dhe në ditën që ka të njëjtin numër si dhe në muajin dhe ditën e momentit (ndodhisë) prej ku fillon të numërohet periudha, përveç në rastin kur ndodhia ka ndodhur më 29 shkurt dhe kur në vitin vijues relevant muaji mbaron me datë 28, periudha skadon më 26 shkurt.

(2) (Periudha të shprehura në muaj) Çdo periudhë e shprehur në muaj do të skadojë, në muajin vijues relevant, në ditën që ka të njëjtin numër si edhe dita prej të cilës ndodhia numërohet, përveç nëse muaji vijues relevant nuk ka ditë me ët njëjtin numër, periudha do të skadojë në ditën e fundit të muajit.

(3) (Periudha të shprehura në ditë) Përlllogaritja e do periudhe të shprehur në ditë do të fillojë me ditën që pason ditën në të cilën ka ndodhur ndodhia relevante dhe do të skadojë në përputhje me të.

(4) (Skadimi në ditën kur Byroja ndërkombëtare ose Enti nuk janë të hapura për publikun) Në qoftë se periudha skadon në ditën kur Byroja ndërkombëtare ose Enti nuk janë të hapura për publikun, periudha do të skadojë, duke mos shpërfillur nenet nga (1) deri (3), ditën e parë vijuese në të cilën Byroja ndërkombëtare ose Enti janë të hapura për publikun.

Rregulli 5
Parregullsi në shërbimet postare dhe në dërgesat

(1) (Komunikata të dërguara përmes postës) Çdo gabim i palës së interesuar në raport me plotësimin e kufizimeve kohore për komunikata të adresuara deri te Byroja ndërkombëtare dhe e dërguar përmes postës do të justifikohet nëse pala e interesuar dorëzon dëshmi me të cilën dëshmohet para Byrosë ndërkombëtare:

- (i) Se komunikata është dërguar përmes postës të paktën pesë ditë para skadimit të kufizimit kohor ose, në rast të shërbimeve postare, gjatë njëjës prej dhjetë ditëve paraprake nga dita e skadimit të kufizimit kohor, të jenë kufizuar nga lufta, revolucioni, trazira civile, greva, fatkeqësi natyrore ose shkaqe të ngjashme, ai komunikim të jetë dërguar jo më vonë se pesë ditë pasi që sërish janë vendosur shërbimet postare;
- (ii) Se dërgesa e komunikatës përmes postës ka qenë me rekomandim, ose se detajet e dërgesës postare kanë qenë të shkruara nga ana e postës në kohën e dërgesës; dhe
- (iii) Në rastet kur të gjitha klasat e postave nuk arrijnë normalisht në Byronë ndërkombëtare në afat prej dy ditësh, se ai komunikim është dërguar me atë klasë postare që normalisht do të arrinte në Byronë ndërkombëtare në afat prej dy ditësh ose me postë ajrore.

(2) (Komunikatë e dërguar përmes shërbimit të dërgesave) Çdo gabim i palës së interesuar në raport me plotësimin e kufizimeve kohore për komunikatë të adresuar deri te Byroja ndërkombëtare dhe e dërguar përmes shërbimit për dërgesa do të justifikohet nëse pala e interesuar dorëzon dëshmi me të cilën dëshmon para Byrosë ndërkombëtare:

- (I) Se komunikata është dërguar të paktën pesë ditë para skadimit të kufizimit kohor ose, në rast të shërbimeve të servilit të dërgesave, gjatë njëjës prej dhjetë ditëve paraprake nga dita e skadimit të kufizimeve kohore, të jenë penguar nga lufta, revolucioni, trazira civile, greva, fatkeqësi natyrore ose shkaqe të ngjashme, ai komunikim të jetë dërguar jo më vonë se pesë ditë pasi sërish janë vendosur shërbimet e servilit për dërgesa.
- (II) Se detajet e dërgesës janë regjistruar nga ana e servisit të dërgesave në kohën e dërgesës.

(2) (Kufizim i justifikimit) Gabimi në plotësimin e kufizimeve kohore do të jetë i justifikuar sipas kësaj Rregulloreje vetëm nëse dëshmia e cekur në paragrafin (1) ose (2) dhe komunikata ose kopja e saj pranohet në Byronë ndërkombëtare jo më vonë se gjashtë muaj pas skadimit të kufizimit kohor.

Rregulli 6

Gjuhët

- (1) (Aplikacioni ndërkombëtar) Aplikacioni ndërkombëtar është në gjuhën angleze ose në gjuhën frënge.
- (2) (Regjistrimi dhe shpallja) Regjistrimi në Regjistrin ndërkombëtar dhe shpallja në Buletinin e regjistrimeve ndërkombëtare dhe çdo e dhënë nga të mëparshmet regjistrohen dhe shpallen sipas kësaj Rregullore, e në varësi të asaj se regjistrimi do të jetë në gjuhë angleze ose franceze. Regjistrimi dhe shpallja e regjistrimit ndërkombëtar do të reflektojë gjuhën në të cilën aplikacioni ndërkombëtar është pranuar nga Byroja ndërkombëtar.
- (3) (Komunikata) Çdo komunikatë që ka të bëjë me aplikacionin ndërkombëtar ose me regjistrimin ndërkombëtar që rezulton nga ajo do të jetë:

(I) në gjuhë angleze ose franceze kur ajo komunikatë është adresuar deri te Byroja ndërkombëtare nga aplikuesi ose bartësi ose nga Enti;

(II) në gjuhën e aplikacionit ndërkombëtar kur komunikata është adresuar nga Byroja ndërkombëtare te Enti, përveç nëse Enti nuk njofton Byronë ndërkombëtare se komunikimi i tërësishëm duhet të jetë në gjuhë angleze ose frënge.

(III) në gjuhën e aplikacioni ndërkombëtar kur komunikata është adresuar nga Byroja ndërkombëtare te aplikuesi ose bartësi përveç nëse aplikuesi ose bartësi shprehin dëshirën që komunikimi i tërësishëm të jetë në gjuhën angleze edhe pse aplikacioni ndërkombëtar ka qenë në gjuhë frënge ose e kundërta.

(4) (Përkthim) Përkthimet e nevojshme për regjistrimin dhe shpalljen sipas paragrafit (2) do të bëhen nga Byroja ndërkombëtare. Aplikuesi mund të plotësojë aplikacionin ndërkombëtar me propozim përkthim të çdo teksti që përmbahet në aplikacionin ndërkombëtar. Në qoftë se Byroja ndërkombëtare konsideron se ai tekst është me gabime, ai do të korrigojohet nga ana e Byrosë ndërkombëtare pas ftesës së dërguar deri tek aplikuesi që të kryej, në afat prej një muaji pas pranimit të ftesës, observim të ndryshimeve të propozuara.

KAPITULLI 2

APLIKACIONET NDËRKOMBËTARE

DHE REGJISTRIMET NDËRKOMBËTARE

Rregulli 7

Kërkesa në lidhje me aplikacionin ndërkombëtar

- (1) (Formulari dhe nënshkrimi) Aplikacioni ndërkombëtar paraqitet në formular

zyrtar. Aplikacioni ndërkombëtar nënshkruhet nga aplikuesi.

(2) (Taksa) Taksat e përshkruara që kanë të bëjnë me aplikacionin ndërkombëtar do të paguhen sipas rregullave 27 dhe 28.

(3) (Përmbajtja e obliguar e aplikacionit ndërkombëtar) Aplikacioni ndërkombëtar përmban ose do të listojë:

- (I) Emrin e aplikuesit, të dhënë sipas udhëzimeve administrative;
- (II) Adresën e aplikuesit, të dhënë sipas udhëzimeve administrative;
- (III) Palën nënshkruese të aplikuesit;
- (IV) Produktin ose produktet që përmbajnë dizajn industrial ose në lidhje me të cilët dizajni industrial duhet të përdoret, me indikacion mbi atë se produkti ose produktet e krijojnë dizajnin industrial ose janë produkte në anë të të cilëve dizajni industrial do duhet të përdoret. Preferohet që produkti ose produktet të identifikohen me përdorimin e terminologjisë që paraqitet në listën e mallrave në klasifikimin ndërkombëtar,
- (V) Numrin e riprodhimeve ose mostrave të dizajnit industrial që shoqërojnë aplikacionin ndërkombëtar sipas rregullit 9 ose 10;
- (VI) Palët nënshkruese të përcaktuara;
- (VII) Shumën e taksave që është paguar dhe mënyrën e pagesës, ose instrument për kreditim të llogarisë të hapur në Byronë ndërkombëtare në lidhje me shumën e taksës, dhe identifikimin e palës që kryen pagesën ose që jep udhëzimet.

(4) (Përmbajtje plotësuese të aplikacionit ndërkombëtar)

(a) Kur aplikacioni ndërkombëtar përmban përcaktim të palës nënshkruese që ka njoftuar drejtorin gjeneral, sipas nenit 5(2)(a) se legjislacioni i saj kërkon një ose më shumë elementë të cekur në nenin 5(2)(b), aplikacioni ndërkombëtar do të përmbajë atë element ose ata elementë, siç është përshkruar në rregullin 11.

(b) Elementi i cekur në pikën (I) ose (II) nga neni 5(2)(b) mundet, sipas zgjedhjes së aplikuesit, të përfshihet në aplikacionin ndërkombëtar edhe kur ai element nuk kërkohet si pasojë e njoftimit sipas nenit 5(2)(a).

(c) Kur aplikohet Rregulli 8, aplikacioni ndërkombëtar duhet të përmbajë indikacione të cekura në Rregullin 8 (2), dhe kur është e zbatueshme, të shoqërohet me deklaratë ose dokument të cekur në atë Rregull.

(d) Kur aplikuesi ka përfaqësues, aplikacioni ndërkombëtar duhet të cekë emrin dhe adresën e përfaqësuesit, të dhënë sipas udhëzimeve administrative;

(e) Kur aplikuesi, sipas nenit 4 të Konventës së Parisit, dëshiron të kërkojë prioritet nga dorëzimi i mëparshëm, aplikacioni ndërkombëtar do të përmbajë edhe deklaratë me kërkesë për prioritet për atë dorëzim (aplikim) të mëparshëm, bashkë me indikacion për emrin e Entit ku është bërë ai aplikim

dhe datën si dhe, kur është e mundur, numrin e aplikimit dhe, kur kërkesa për prioritet nuk ka të bëjë me të gjithë dizajnet industrial të përmbajtura në aplikacionin ndërkombëtar, indikacion për ato dizajne industrial për të cilët ka të bëjë kërkesa për prioritet ose për cilët nuk ka të bëjë.

(f) Kur aplikuesi dëshiron të shfrytëzojë përparësitë nga neni 11 i Konventës së Parisit, aplikacioni ndërkombëtar do të përmbajë deklaratë se produkti ose produktet që formojnë dizajnin industrial ose në të cilin është inkorporuar dizajni industrial janë paraqitur në ekspozitë zyrtare ose zyrtarisht janë pranuar në ekspozitë ndërkombëtare, bashkë me vendin ku është mbajtur ekspozita dhe datën në të cilën produkti, ose produktet janë ekspozuar dhe, kur bëhet fjalë jo për të gjithë dizajnet industrial që përmbahen në aplikacionin ndërkombëtar, indikacion për ato dizajne industrial për të cilat ka të bëjë deklarata ose mbi të cilat nuk ka të bëjë.

(g) Kur aplikuesi dëshiron që shpallja e dizajnit industrial të prolongohet sipas nenit 11, aplikacioni ndërkombëtar duhet të përmbajë kërkesë për prolongim (shtyrje) të shpalljes.

(h) Aplikacioni ndërkombëtar mundet gjithashtu, të përmbajë deklaratë ose indikacion tjetër relevant të specifikuar në udhëzimet administrative.

(i) Aplikacioni ndërkombëtar mund të shoqërohet me deklaratë që identifikon informacionin e njohur nga aplikuesi me çka ajo bëhet material i kualifikuar për mbrojtje të dizajnit industrial në fjalë.

(5) (Pa gjëra shtesë) Nëse aplikacioni ndërkombëtar përmban gjëra që nuk kërkohen me Akt, me këtë Rregullore ose me udhëzimet administrative, Byroja ndërkombëtare do t'i fshijë ex officio. Nëse aplikacioni ndërkombëtar është shoqëruar me dokument që nuk kërkohet ose është i ndaluar, Byroja ndërkombëtare mund të lirohet nga ai dokument.

(6) (Të gjithë produktet nga e njëjta klasë) Të gjithë produktet që e formojnë dizajnin industrial për të cilin ka të bëjë aplikacioni ndërkombëtar, ose janë në lidhje me përdorimin tek dizajni industrial, do t'i takojnë të njëjtës klasë të klasifikimit ndërkombëtar.

Rregulli 8

Kërkesa të veçanta lidhur me aplikuesin

(1) (Njoftim për kërkesa të veçanta) (a) Kur legjislacioni i Palës nënshkruese kërkon që aplikacioni për mbrojtjen e pronësisë industriale të dorëzohet në emër të kreatorit (krijuesit) të dizajnit industrial, ajo palë nënshkruese mundet, përmes deklaratës, të njoftojë Drejtorin gjeneral lidhur me këtë fakt.

(b) Deklarata e cekur në nënparagrafin (a) do të specifikojë formën dhe përmbajtjen e detyrueshme të çdo deklaratë ose dokumenti që kërkohet për qëllimet e paragrafit (2).

(2) (Incident i kreatorit (krijuesit) dhe transferimi i aplikacionit ndërkombëtar) Kur aplikacioni ndërkombëtar përmban përcaktim të palës nënshkruese e cila ka dorëzuar deklaratë sipas paragrafit (1):

- (I) Ajo gjithashtu, do të përmbajë identitetin e krijuesit të dizajnit industrial bashkë me deklaratë, me të cilën plotësohen kërkesat e specifikuar sipas paragrafit (1)(b) se ky i fundit beson se ai është krijuesi i dizajnit industrial; personi që është identifikuar si krijues do të konsiderohet të jetë aplikuesi për qëllime të përcaktimit të palës nënshkruese, pa marrë parasysh personin e potencuar si aplikues sipas Rregullit 7(3)(I).
- (II) Kur personi i identifikuar si krijues, është personi që nuk është potencuar në aplikacion sipas rregullit 7(3)(I), aplikacioni ndërkombëtar do të shoqërohet me deklaratë ose dokument, që i plotëson kërkesat e specifikuar në paragrafin (1)(b) me vlefshmëri se ai është transferuar nga personi i identifikuar si krijues në personin e emëruar si aplikuesi. Ky i fundit do të regjistrohet si bartës i aplikacionit ndërkombëtar.

Rregulli 9 **Riprodhimi i dizajnit industrial**

(1) (Reforma dhe numri i riprodhimeve të dizajnit industrial) (a) Riprodhimet e dizajnit industrial, sipas zgjedhjes së aplikuesit, do të jenë në formë të fotografive ose paraqitjeve të tjera grafike të dizajnit industrial ose të produktit ose produkteve që përmbajnë dizajnin industrial. I njëjti produkt mund të përfshihet në të njëjtën fotografi ose prezantim (paraqitje) tjetër grafike me kualitet që mundëson të gjitha detajet e dizajnit industrial të jenë të ndara qartë dhe të mundësohet publikimi (shpallja).

(2) (Kërkesa lidhur me riprodhimet) (a) Riprodhimet do të jenë me cilësi që mundësojnë të gjitha detajet e dizajnit industrial të jenë të ndara në mënyrë të qartë dhe të mundësojnë shpalljen.

(b) Gjërat që janë paraqitur në riprodhim, por për të cilat nuk është kërkuar mbrojtje, mund të ceken siç është parashikuar në udhëzimet administrative.

(3) (Dukje(pamje) të kërkuara) (a) Lëndë e nënparagrafit (b), çdo palë nënshkruese që kërkon pamje të caktuara në mënyrë specifike të produktit ose produkteve që përmbajnë dizajnin industrial ose që janë në relacion me përdorimin e dizajnit industrial, përmes një deklaratë, me të cilën njoftohet

drejtori gjeneral, do të specifikojë pamjet që kërkohen si dhe kushtet që kërkohen.

(b) Asnjë nga palët nënshkruese nuk mund të kërkojë më shumë se një pamje (paraqitje/dukje) kur dizajni industrial ose produkti janë dydimensional, ose më shumë se gjashtë pamje kur produkti është tredimensional.

(4) (Refuzim në bazë të korrelacionit me riprodhimet e dizajnit industrial). Pala nënshkruese nuk mund të refuzojë hyrjen në fuqi të regjistrimit ndërkombëtar në bazë të asaj që kërkesat që kanë të bëjnë me format e riprodhimeve të dizajnit industrial janë plotësuar ose të ndryshme nga të përcaktuarat, derisa tek ajo palë nënshkruese në lidhje me paragrafin (3)(a) nuk janë plotësuar kërkesat sipas ligjit të saj. Pala nënshkruese mund të refuzoj vlefshmërinë e regjistrimit ndërkombëtar në bazë të asaj që riprodhimet që përmbahen në regjistrimin ndërkombëtar nuk janë mjaftueshëm të plotë për të zbuluar dizajnin.

Rregulli 10

Mostra të dizajnit industrial kur kërkohet prolongim i shpalljes

(1) (Numri i mostrave) Kur aplikacioni ndërkombëtar përmban kërkesë për prolongim të shpalljes në lidhje me dizajnin dydimensional dhe në vend se të jetë e shoqëruar me riprodhime të cekura në Rregullin 9, ajo është e shoqëruar me mostra të dizajni industrial, numri i vijues i mostrave do ta shoqërojë aplikacionin ndërkombëtar:

- (I) Një mostër për Byronë ndërkombëtare
- (II) Një mostër për çdo Ent të caktuar që ka njoftuar Byronë ndërkombëtare sipas nenit 10(5) se dëshiron të pranojë kopje të regjistrimit ndërkombëtar.

(2) (Mostra) Të gjitha mostrat do të përmbahen në një pako të vetme. Mostrat mund të jenë të mbështjella. Dimensioni maksimal dhe pesha e pakos është e specifikuar me udhëzimet administrative.

Rregulli 11

Identiteti i kreatorit (krijuesit); përshkrimi; kërkesa

(1) (Identiteti i krijuesit) Kur aplikacioni ndërkombëtar përmban indikacione që kanë të bëjnë me identitetin e krijuesit të dizajnit industrial, emri dhe adresa e tij do të potencohen sipas udhëzimeve administrative.

(2) (Përshkrim) Kur aplikacioni ndërkombëtar përmban përshkrim, letra do të

përmbajë ato fotografi që paraqiten në riprodhimet e dizajnit industrial. Nëse përshkrimi tejkalon 100 fjalë, do të paguhet taksë plotësuese, siç është e parashikuar në Listën e taksave.

(3) (Kërkesa) Deklarata, në përputhje me neni n5(2)(a), se ligji i palës nënshkruese kërkon kërkesë me qëllim që aplikacioni për njohjen e mbrojtjes së dizajnit industrial të dorëzohet sipas atij ligji, do të specifikojë qartë fjalët e kërkesës së shtruar. Kur aplikacioni ndërkombëtar përmban kërkesë, potencomi në atë kërkesë do të specifikohet si në deklaratën në fjalë.

Rregulli 12 **Taksa në lidhje me aplikacione ndërkombëtare**

(1) (Tarifat e përshkruara) (a) Aplikacioni ndërkombëtar do të jetë subjekt i pagesës së taksave vijuese:

- (i) Taksës (tarifës) bazë,
- (ii) Taksës standarde për përcaktim, në lidhje me palën nënshkruese të përcaktuar e cila nuk ka dorëzuar deklaratë sipas nenit 7(2);
- (iii) Takës individuale për përcaktim, në lidhje me ndonjë palë nënshkruese të përcaktuar e cila ka dorëzuar deklaratë sipas nenit 7(2);
- (iv) Taksë për shpallje.

(b) Shuma e taksave të cekura në pikat (I), (II) dhe (IV) janë të përcaktuara në Listën e taksave.

(2) (Kur paguhen taksat) Taksat e cekura në paragrafin (1), lëndë e paragrafit (3), paguhen në kohën e dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar përveç nëse, në rastet kur aplikacioni ndërkombëtar përmban kërkesë për prolongim të shpalljes, taksa për shpallje mund të paguhet më vonë, sipas rregullit 16(3).

(3) (Taksa për përcaktim individual e cila paguhet në dy pjesë) (a) Deklarata e dhënë sipas nenit 7(2) gjithashtu mund të specifikojë se taksa e përcaktimit individual duhet të paguhet për palën nënshkruese në dy pjesë, pjesa e parë të paguhet në kohën e dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar, ndërsa pjesa e dytë të paguhet në një datë të mëvonshme që është përcaktuar sipas ligjit të palës nënshkruese.

(b) Kur zbatohet nënparagrafi (a), referencat nga paragrafi 1 (III) për taksë për përcaktim individual kanë të bëjnë me pjesën e parë të taksës për përcaktim individual.

(c) Pjesa e dytë e taksës për përcaktim individual mund të paguhet ose drejtpërdrejt deri tek Enti për të cilin bëhet fjalë ose përmes Byrosë ndërkombëtare, sipas zgjedhjes së bartësit. Kur paguhet drejtpërdrejt tek Enti për të cilin bëhet fjalë, Enti do të njoftojë Byronë ndërkombëtare menjëherë dhe Byroja ndërkombëtare do ta regjistrojë çdo njoftim të tillë në regjistrin

ndërkombëtar. Kur paguhet përmes byrosë ndërkombëtare, byroja ndërkombëtare do të regjistrojë çdo pagesë të tillë në regjistrin ndërkombëtar dhe menjëherë do të njoftojë Entin për të cilin bëhet fjalë.

(d) Kur pjesa e dytë e taksës për përcaktim individual është paguar në periudhën e aplikueshme, Enti do të njoftojë Byronë ndërkombëtare dhe do të kërkojë nga Byroja ndërkombëtare ta anulojë regjistrimin ndërkombëtar në regjistrin ndërkombëtar në lidhje me palën nënshkruese për të cilën bëhet fjalë. Byroja ndërkombëtare do të veprojë menjëherë dhe për këtë do ta njoftojë bartësin.

Rregulli 13

Aplikacioni ndërkombëtar i dorëzuar përmes Entit

(1) (Data e pranimit tek Enti dhe transferimi në Byronë ndërkombëtare) Kur aplikacioni ndërkombëtar është dorëzuar përmes Entit të palës nënshkruese të aplikuesit, ai Ent do të njoftojë aplikuesin për datën në të cilën ka marrë aplikacionin. Në të njëjtën kohë kur do të transferoj aplikacionin ndërkombëtar deri te Byroja ndërkombëtare, Enti do të njoftojë byronë ndërkombëtare për datën në të cilën ka marrë aplikacionin. Enti do të njoftojë aplikuesin për të informuar se e ka dërguar aplikacionin ndërkombëtar deri te Byroja ndërkombëtare.

(2) (Taksë për transferim (bartje))Enti që kërkon taksë për transferim, siç është paraparë me neni 4 (2), do të njoftojë Byronë ndërkombëtare për shumën e asaj takse, shumën e përgjithshme e së cilës nuk do të tejkalojë shpenzimet administrative të pranimit dhe transferimit të aplikacionit ndërkombëtar.

(3) (Data e dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar të dorëzuar në mënyrë indirekte) Lëndë e nenit 9 (3), data e dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar e sjellë përmes Entit do të jetë:

- (I) Data në të cilën aplikacioni ndërkombëtar është pranuar nga ai Ent, duke paraparë që ajo është pranuar në Byronë ndërkombëtare në afat prej një muaji nga ajo datë;
- (II) Në çfarëdo rasti tjetër, data në të cilën Byroja ndërkombëtare ka pranuar aplikacionin ndërkombëtar.

(4) (Data e dorëzimit kur pala nënshkruese e aplikuesit kërkon pastrim (qartësim) sigurie) Duke mos mohuar paragrafin 9 (3), pala nënshkruese, ligji i së cilës në kohën kua ajo është bërë pjesë e këtij Akti, kërkon pastrim (qartësim) sigurie, mundet, përmes një deklaratë, të njoftojë drejtorin gjeneral se periudha prej një muaji e potencuar në atë paragraf do të zëvendësohet me periudhë prej gjashtë muajsh.

Rregulli 14
Shqyrtimi (Ekzaminimi) nga Byroja ndërkombëtare

(1) (Kufizim kohor për korrigjim të parregullive) Kufizimi i paraparë kohor për korrigjim të parregullive sipas nenit 8 do të jetë tre muaj nga data e ftesës së dërguar nga Byroja ndërkombëtare.

(2) (Parregullsi që kërkojnë prolongim të datës së dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar) Parregullsitë të cilat, sipas nenit 9 (3) janë të përshkruara si të tilla që kërkojnë prolongimin e datës së dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar janë si në vijim:

(a) aplikacioni ndërkombëtar nuk është në gjuhën e duhur ose në një nga gjuhët e duhura

(b) një nga elementët në vijim mungon në aplikacionin ndërkombëtar.

- (I) Indikacion i qartë ose implicit se kërkohet regjistrim ndërkombëtar sipas këtij akti;
- (II) Indikacione që mundësojnë të përcaktohet identiteti i aplikuesit;
- (III) Indikacione të pamjaftueshme për të kontaktuar aplikuesin ose përfaqësuesin, nëse ka të tillë;
- (IV) Riprodhimi, ose, sipas nenit 5 (1) (III), mostra nga çdo dizajn industrial që është lëndë e aplikacionit ndërkombëtar;
- (V) Përcaktimi i më së paku një Pale nënshkruese.

(3) (Kthimi i taksave) Në rastet kur, sipas nenit 8 (2)(a) konsiderohet se aplikacioni është braktisur, Byroja ndërkombëtare do t'i kthejë taksat që kanë të bëjnë me atë aplikacion, pas marrjes së shumës që korrespondon me taksën bazë.

Rregulli 15
Regjistrimi i dizajnit industrial në
Regjistrin ndërkombëtar

(1) (Regjistrimi i dizajnit industrial në regjistrin ndërkombëtar) Kur Byroja ndërkombëtare konstaton se aplikacioni ndërkombëtar është në përputhje me kërkesat e zbatueshme, ajo do të regjistrojë dizajnin industrial në Regjistrin ndërkombëtar dhe do t'i dërgojë vendim aplikuesit.

(2) (Përmbajtja e regjistrimit) Regjistrimi ndërkombëtar do të përmbajë:

- (I) Të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me aplikacionin ndërkombëtar, përveç kërkesat për prioritet ose Rregullit 7 (4)(e) kur data e aplikimit të mëparshëm është më shumë se gjashtë muaj para datës së dorëzimit të aplikacionit ndërkombëtar;
- (II) Çdo riprodhim të dizajnit industrial
- (III) Datën e regjistrimit ndërkombëtar

- (IV) Numrin e regjistrimit ndërkombëtar
- (V) Klasat relevante të Klasifikimit ndërkombëtar siç është përcaktuar nga Byroja ndërkombëtare.

Rregulli 16 **Prolongimi i shpalljes**

(1) (Periudha maksimale e prolongimit (shtyrjes)) Periudha e parashikuar për nevojat e nenit 11 (1)(l) dhe (2)(l) do të jetë 30 muaj nga data e dorëzimit, ose kur kërkohet prioritet, nga data e prioritetit të aplikacionit për të cilën bëhet fjalë.

(2) (Periudha e tërheqjes së përcaktimit kur prolongimi nuk është i mundshëm sipas ligjit të zbatueshëm) Periudha e cekur në neni 11 (3) (l) për aplikuesin të tërheq përcaktimin e palës nënshkruese ligji i së cilës nuk lejon tërheqjen e shpalljes do të jetë një muaj nga data e njoftimit të dërguar nga Byroja ndërkombëtare.

(3) (Periudha për pagesën e taksës për shpallje dhe dorëzimi i riprodhimeve) Taksa për shpallje e cekur në Rregullin 12 (1)(a)(b) do të paguhet dhe riprodhimet e cekura në nenin 11 (6)(b) do të dorëzohen, para se periudha e prolongimit sipas nenit 11 (2) të skadojë, ose para se të skadojë periudha e prolongimit sipas nenit 11 (4) (a).

(4) (Regjistrim i riprodhimeve) Byroja ndërkombëtare do të regjistrojë në Regjistrin ndërkombëtar të gjitha riprodhimet e dorëzuara sipas nenin 11(6)(b).

(5) (Kërkesa të pakompletuara) Në qoftë se kërkesat e cekura në paragrafin 9 (3) nuk janë plotësuar, regjistrim ndërkombëtar do të anulohet dhe nuk do të shpallet.

Rregulli 17 **Shpallja e regjistrimit ndërkombëtar**

(1) (Koha e shpalljes) Regjistrimi ndërkombëtar do të shpallet

- (I) kur aplikuesi e kërkon atë, menjëherë pas regjistrimit;
- (II) kur kërkohet prolongim i shpalljes dhe kur kërkesa nuk është plotësuar, menjëherë pas datës në të cilën skadon afati për mosshpallje.
- (III) Në çfarëdo rasti tjetër, gjashtë muaj pas datës së regjistrimit ndërkombëtar ose sa më shpejt që është e mundur pas saj.

(2) (Përmbajtja e shpalljes) Shpallja e regjistrimit ndërkombëtar në Buletin, sipas nenit 10 (3), do të përmbajë:

- (I) Të dhëna të regjistruara në Regjistrin ndërkombëtar;
- (II) Riprodhim ose riprodhime të dizajnit industrial;
- (III) Kur shpallja është prolonguar, përcaktim të datës në të cilën periodha e prolongimit skadon ose konsiderohet se skadon.

Kapitulli 3 **REFUZIME DHE ÇREGJISTRIME (ANULIME)**

Rregulli 18 **Njoftim për refuzim**

(1) (Periodha për njoftim për refuzim) (a) Periodha e përshkruar për njoftim për refuzim të vlefshmërisë së regjistrimit ndërkombëtar sipas nenit 12(2) do të jetë gjashtë muaj nga data në të cilën Byroja ndërkombëtare dërgon deri tek Enti kopje të shpalljes së regjistrimit ndërkombëtar.

(b) Duke mos mohuar nënparagrafin (a), çdo Palë nënshkruese Enti i së cilës është ent ekzaminues, ose ligji i së cilës parasheh mundësinë e kundërshtimit të mbrojtjes së pranuar, mundet, përmes një deklaratë, të njoftojë drejtorin gjeneral se periodha prej gjashtë muajsh që është e paraparë në atë nënparagrafi do të zëvendësohet me periodhë prej 12 muaj.

(c) në deklaratën e cekur në nënparagrafin (b) mund të deklarohet se regjistrimi ndërkombëtar do të jetë në vlefshmëri siç është cekur në neni 14 (2)(a) më së voni:

- (I) Në kohën e specifikuar në deklaratën e cila mund të jetë datë e mëvonshme nga data e cekur në atë nen, por jo më shumë se gjashtë muaj nga data e cituar, ose
- (II) Në kohë në të cilën mbrojtja është e pranuar sipas ligjit të palës nënshkruese kur vendimi që ka të bëjë me mbrojtjen e pranuar nuk është dorëzuar në periodhën e aplikueshme sipas nënparagrafit (a) ose (b); në rast të tillë Enti i palës nënshkruese do të njoftojë Byronë ndërkombëtare menjëherë dhe do t'i dërgojë vendimin e tillë bartësit të regjistrimit ndërkombëtar menjëherë më pas.

(2) (Njoftim për refuzim) (a) Njoftim për çfarëdo qoftë refuzimi që ka të bëjë me regjistrimin ndërkombëtar do të datohet dhe nënshkruhet nga Enti që lëshon njoftimin.

- (I) Enti që lëshon njoftimin;
- (II) Numri i regjistrimit ndërkombëtar
- (III) Të gjitha arsyet mbi të cilat refuzimi bazohet bashkë me referencën për dispozitat ligjore korrespondente;
- (IV) Kur shkaku mbi të cilin bazohet refuzimi ka të bëjë me ngjashmëri me dizajnin industrial që ka qenë lëndë e

- aplikacionit të mëparshëm nacional, regjional ose ndërkombëtar, data e dorëzimit dhe numri, data e prioritetit (nëse ka të tillë), data e regjistrimit dhe numri (nëse është i disponueshëm), kopje e riprodhimit të dizajnit të mëhershëm industrial (nëse ai riprodhim është i qasshëm (në dispozicion) për publikun) dhe emrin dhe adresën e pronarit të dizajnit industrial në fjalë;
- (V) Kur refuzimi nuk ka të bëjë me të gjitha dizajnet industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar, ato për të cilët bëhet fjalë ose për ato për të cilët nuk bëhet fjalë;
 - (VI) Kur refuzimi mund të jetë lëndë e shqyrtimit ose ankesës dhe, në qoftë se kufizimi kohor, arsyeshëm sipas rrethanave, për çdo kërkesë për shqyrtim ose ankesë kundër refuzimit dhe organit deri te cili është dorëzuar kjo kërkesë për shqyrtim ose ankesë, me shënim, kur është e zbatueshme, se kërkesa për shqyrtim ose ankesa duhet të dorëzohet përmes ndërmjetësimit të përfaqësuesit adresa e të cilit është në territorin e palës nënshkruese Enti i së cilës ka shqiptuar atë refuzim, dhe
 - (VII) Datën në të cilën është shqiptuar refuzimi.

(3) (Njoftim për një pjesë të regjistrimit ndërkombëtar) Në raste kur, duke ndjekur njoftimin për refuzim sipas nenit 13(2), regjistrimi është ndarë para Entit të palës nënshkruese të përcaktuar me qëllim tejkalimi të shkakut të refuzimit të cekur në njoftim, ai Ent do të njoftojë Byronë ndërkombëtare për atë të dhënë që ka të bëjë me ndarje siç është specifikuar në udhëzimet administrative.

(4) (Njoftim për tërheqje të refuzimit) (a) Njoftimi për çdo tërheqje që ka të bëjë me çdo regjistrim ndërkombëtar do të datohet dhe nënshkruhet nga Enti që e lëshon atë njoftim.

(b) Njoftimi do të përmbajë ose do të potencojë:

- (I) Entin që ka lëshuar njoftimin
- (II) Numrin e regjistrimit ndërkombëtar
- (III) Kur tërheqja nuk ka të bëjë me të gjitha dizajnet industrial, dizajnet mbi të cilët zbatohet refuzimi, atyre për të cilët bëhet fjalë ose për të cilët nuk bëhet fjalë, dhe
- (IV) (Arkivimi) Byroja ndërkombëtare do të regjistrojë çdo njoftim sipas paragrafit 1(c)(II), (2) ose (4) në regjistrin ndërkombëtar bashkë me, në rast të njoftimit për refuzim, indikacion të datës në të cilën njoftimi për refuzim është dërguar në Byronë ndërkombëtare.

(6) (Bartja e kopjeve të njoftimeve) Byroja ndërkombëtare do të bart kopjet e njoftimeve të pranuar sipas paragrafëve 1(c)(II), (2) ose (4) deri te bartësi.

Rregulli 19 **Refuzime jo të rregullta**

(1) (Njoftim që nuk konsiderohet si i tillë) (a) Njoftimi për refuzim nuk do të merret si i tillë nga Byroja ndërkombëtare dhe nuk do të arkivohet në regjistrin ndërkombëtar:

- (I) Nëse nuk liston numrin e regjistrimit ndërkombëtar për të cilin bëhet fjalë, përveç nëse indikacionet e tjera përmbajnë me njoftimin miratim me të cilin regjistrimi në fjalë do të jetë i identifikuar;
- (II) Nëse nuk i identifikon shkaqet e refuzimit, ose
- (III) Nëse është dërguar deri tek Byroja ndërkombëtare pas skadimit të periudhës së zbatueshme sipas rregullit 18(1).

(b) Kur rrimërohet nënparagrafi (a), Byroja ndërkombëtare, përveç nëse nuk mund të identifikojë regjistrimin ndërkombëtar për të cilën bëhet fjalë, do të dorëzojë kopje me njoftimin deri tek bartësi, në të njëjtën kohë, do të informojë bartësin dhe Entin që ka dërguar njoftimin se njoftimi për refuzim nuk konsiderohet si i tillë nga Byroja ndërkombëtare dhe nuk ka arsye të regjistrohet në Regjistrin ndërkombëtar, dhe do të potencojë shkaqet për to.

(2) (Njoftime jo të rregullta) Në qoftë se njoftimi për refuzim

- (I) Nuk është e nënshkruar në emër të Entit që ka dërguar refuzimin, ose nuk është në pajtueshmëri me kërkesat nga rregulli 2,
- (II) Nuk është në përputhje, aty ku është e zbatueshme, me kërkesat e Rregullit 18 (2)(b)(iv),
- (III) Nuk potencon, aty ku është e zbatueshme, organin deri tek cili kërkesa për shqyrtim ose ankesë është dorëzuar dhe kufizimin e zbatueshëm kohor për shqyrtimin e asaj kërkesë apo ankesë (Rregulli 18(2)(6)(iv),
- (IV) Nuk potencon datën në të cilën është shqiptuar refuzimi (Rregulli 18 (2)(b)(iv).

Byroja ndërkombëtare do të regjistrojë refuzimin në regjistrin ndërkombëtar dhe do të dorëzojë kopje të atij njoftimi deri tek bartësi. Nëse kjo kërkohet nga bartësi, Byroja ndërkombëtare do të ftojë Entin që ka dorëzuar refuzimin, të arsyetojë njoftimin e tij pa prolongime.

Rregulli 20 **Anulime në palët nënshkruese të përcaktuara**

(1) (Përmbajtja e njoftimit për anulim) Kur vlefshmëria e regjistrimit ndërkombëtar anulohet në palën nënshkruese të përcaktuar dhe kur anulimi më nuk është lëndë e shqyrtimit ose ankesës, Enti i palës nënshkruese, organi autorizues i të i cili ka shpallur anulimin, menjëherë do të njoftojë për

këtë Byronë ndërkombëtare. Njoftimi do të përmbajë:

- (I) Organin që ka kryer anulimin
- (II) Faktin se anulimi më nuk është lëndë e ankesës
- (III) Numrin e regjistrimit ndërkombëtar
- (IV) Kur anulimi nuk ka të bëjë me të gjithë dizajnët industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar, ato për të cilët bëhet fjalë dhe ato për të cilët nuk bëhet fjalë
- (V) Data në të cilën anulimi është shpallur dhe data e hyrjes në fuqi.

(2) (Arkivimi i anulimeve) Byroja ndërkombëtare do të arkivojë anulimin në regjistrin ndërkombëtar, bashkë me të dhënat e përmbajtura në njoftimin për anulim.

Kapitulli 4 ***NDRYSHIME DHE KORRIGJIME***

Rregulli 21 ***Regjistrimi i ndryshimeve***

(1) (Paraqitja e kërkesës) (a) Kërkesa do të paraqitet deri tek Byroja ndërkombëtare në formular relevant zyrtar kur kërkesa ka të bëjë me një nga këto në vijim:

- (I) Ndryshim të pronësisë së regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me të gjithë ose me ndonjë nga dizajnët industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar;
- (II) Ndryshim të emrit dhe adresës së bartësit
- (III) Tërheqje (heqje dorë) nga regjistrimi ndërkombëtar në lidhje me një ose me të gjitha palët nënshkruese të përcaktuara;
- (IV) Kufizime në lidhje me një ose me të gjitha palët nënshkruese për një ose për të gjithë dizajnët industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar

b) Kërkesa do të paraqitet nga bartësi dhe nënshkruhet nga bartësi; sidoqoftë, kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në pronësi mund të paraqitet edhe nga pronari i ri, duke paraparë që ajo është:

- (I) Nënshkruar nga bartësi, ose
- (II) Nënshkruar nga bartësi i ri dhe shoqëruar me vërtetim të organit të autorizuar të palës nënshkruese të bartësit se bartësi i ri paraqitet si suksesor (trashëgimtar/pasardhës) i titullit të bartësit.

(2) (Përmbajtja e kërkesës) Kërkesa për regjistrimin e ndryshimit, në lidhje me ndryshimin e kërkuar, do të përmbajë ose do të potencojë:

- (I) Numrin e regjistrimit ndërkombëtar për të cilin bëhet fjalë
- (II) Emrin e bartësit, përveç nëse ndryshimi nuk ka të bëjë me emrin dhe adresën e përfaqësuesit,
- (III) Në rast të ndryshimit të pronësisë së regjistrimit ndërkombëtar, emrin dhe adresën, të dhëna sipas udhëzimeve administrative, të bartësit të ri të regjistrimit ndërkombëtar
- (IV) Në rast të ndryshimit të pronësisë së regjistrimit ndërkombëtar, pala ose palët nënshkruese në lidhje me të cilët pronari i ri i plotëson kushtet sipas nenit 3, për të qenë bartës i regjistrimit ndërkombëtar
- (V) Në rast të ndryshimit të pronësisë së regjistrimit ndërkombëtar që ka të bëjë me të gjithë dizajnet industrial dhe të gjithë palët nënshkruese, numri i dizajneve industrial dhe palëve nënshkruese të përcaktuara për të cilët ka të bëjë ndryshimi në pronësi, dhe
- (VI) Shuma e taksës e cila paguhet dhe mënyra e pagesës, ose instruksione për kreditim të shumës së kërkuar të taksave nga llogaria e hapur në Byronë ndërkombëtare dhe identifikimi i palës që do të kryej pagesën ose që do të jap instruksionet.

(3) (Kërkesa jo e rregullt) Në qoftë se kërkesa nuk është në përputhje me kërkesat e zbatueshme, Byroja ndërkombëtare do të njoftojë bartësin për këtë dhe, nëse kërkesa është bërë nga personi që kërkon të bëhet pronari i ri, edhe ai person.

(4) (Periudhë e lejuar për ndryshim të parregullsisë) Parregullsitë mund të ndryshohen në periudhë prej tre muajve nga data e njoftimit për parregullsi nga Byroja ndërkombëtare. Në qoftë se parregullsia nuk ndryshohet në këto tre muaj, kërkesa do të konsiderohet si e refuzuar dhe Byroja ndërkombëtare do të njoftojë menjëherë bartësin dhe, nëse kërkesa është dorëzuar nga personi që kërkon të bëhet pronar i ri, ai person, dhe do ta kthej taksën e paguar, pas minusimit të shumës që korrespondon me një gjysmë të taksës relevante.

(5) (Regjistrimi i njoftimit për ndryshim) (a) Byroja ndërkombëtare, në qoftë se kërkesa është në rregull, menjëherë do të regjistrojë ndryshimin në regjistrin ndërkombëtar dhe do ta njoftojë bartësin. Në rast të regjistrimit të ndryshimit në pronësi, Byroja ndërkombëtare do të informojë bartësin e i dhe të vjetër.

(b) Ndryshimi do të regjistrohet në datën e pranimit të kërkesës në Byronë ndërkombëtare.

Në rast kur kërkesa e cekur se ndryshimi duhet të regjistrohet pas ndryshimit

tjetër, ose pas rinovimit (ripërtëritjes) të regjistrimit ndërkombëtar, Byroja ndërkombëtare do të veprojë sipas asaj.

(6) (Regjistrimi i ndryshimeve të pjeshme në pronësi) Bartja ose transferim tjetër i regjistrimit ndërkombëtar në lidhje me vetëm disa dizajnë industrial ose në lidhje me vetëm disa nga palët nënshkruese të përcaktuar do të regjistrohen në regjistrin ndërkombëtar nën numrin e regjistrimit ndërkombëtar pjesa e të cilit është bartur ose transferuar në ndonjë mënyrë tjetër; çdo pjesë të bartur ose të transferuar në ndonjë mënyrë tjetër do të anulohet nën numrin e regjistrimit ndërkombëtar në fjalë dhe do të regjistrohet si regjistrim i veçantë ndërkombëtar. Regjistrimi ndërkombëtar i veçantë do të mbajë numrin e regjistrimit ndërkombëtar pjesa e të cilit është bartur ose është transferuar në ndonjë mënyrë tjetër, bashkë me shkronjë të madhe.

(7) (Regjistrimi i bashkimit të regjistrimeve ndërkombëtare) Kur i njëjti person bëhet bartës i dy e më shumë regjistrimeve ndërkombëtare që është pjesërisht ndryshim i pronësisë, regjistrimi do të bashkohet me kërkesë të personit të cekur në paragrafin (1) deri (6) mutatis mutandis. Regjistrimi ndërkombëtar që është rezultat i bashkimit do të bartë numrin e regjistrimit ndërkombëtar pjesa e të cilit është bartur ose transferuar në ndonjë mënyrë tjetër, bashkë me, kur kjo është e zbatueshme, me shkronjë të madhe.

Rregulli 22 ***Korrigjimi i Regjistrimit ndërkombëtar***

(1) (Korrigjimi) Kur Byroja ndërkombëtare, duke punuar ex officio ose me kërkesë të bartësit, duke konsideruar se nuk ka gabim në regjistrimin ndërkombëtar në regjistrin ndërkombëtar, do të modifikojë regjistrin dhe menjëherë do të njoftojë bartësin.

(2) (Refuzimi i vlefshmërisë së korrigjimeve) Enti i palës nënshkruese të përcaktuar do të ketë të drejtë të deklarojë me njoftim deri tek Byroja ndërkombëtare se refuzon të pranojë vlefshmërinë e korrigjimeve. Nenet 12 dhe Rregullat 18 e 19 do të zbatohen mutatis mutandis.

Kapitulli 5 ***RINOVIMI (RIPËRTËRITJA)***

Rregulli 23 ***Njoftim jozyrtar për skadim***

Gjashtë muaj para skadimit të afatit prej pesë vitesh, Byroja ndërkombëtare do t'u dërgojë bartësit dhe përfaqësuesit, nëse ka të tillë, njoftim në të cilin ceket data e skadimit të regjistrimit ndërkombëtar. Fakti se njoftimi në fjalë nuk është pranuar, nuk paraqet arsyetim për gabimin (lëshimin) që ët plotësohen kërkesat për kufizime kohore të cekura në Rregullin 24.

Rregulli 24

Detaje në lidhje me rinovimin

(1)(Taksa) (a) Regjistrimi ndërkombëtar do të rinovohet pas pagesës së taksave vijuese:

- (i) Taksa (tarifa) bazë
- (ii) Taksa standarde për përcaktim në lidhje me çdo palë nënshkruese të përcaktuar që nuk ka dorëzuar deklaratë sipas nenit 7 (2) dhe për të cilën regjistrimi ndërkombëtar duhet të rinovohet.
- (iii) Taksa individuale për përcaktim për çdo palë nënshkruese të përcaktuara që ka dorëzuar deklaratë sipas nenit 7(2) dhe për të cilën regjistrimi ndërkombëtar duhet të rinovohet.

(b) Shuma e taksave të cekura në pikën (I) dhe (II) të nënparagrafit (a) janë caktuar në listën e taksave.

(c) Pagesa e taksave të cekura në nënparagrafin (a) do të kryhet më së voni në datën e fundit në të cilën duhet të kryhet ripërtëritja (rinovimi) i regjistrimit ndërkombëtar. Sidoqoftë, kjo megjithatë mund të kryhet në gjashtë muajt vijues nga data e ripërtëritjes së regjistrimit ndërkombëtar, duke parashikuar që shuma e cekur për atë, e parashikuar në Listën e taksave, është paguar në të njëjtën kohë.

(d) Nëse ndonjë pagesë për qëllime rinovimi të regjistrimi ndërkombëtar është pranuar në Byronë ndërkombëtare tre muaj më herët se data e ripërtëritjes së regjistrimit ndërkombëtar, ajo do të konsiderohet si e pranuar tre muaj para asaj date.

(4) (Detaje të mëtutjeshme) (a) Kur bartësi nuk dëshiron të kryej rinovim (ripërtëritje) të regjistrimit ndërkombëtar

- (I) Në lidhje me palën nënshkruese të përcaktuar, ose
- (II) Në lidhje me ndonjë nga dizajnët industrial që janë lëndë e regjistrimit ndërkombëtar, pagesa e taksës së kërkuar do të shoqërohet me deklaratë në të cilën potencohet Pala nënshkruese ose numri i dizajnëve industrial për të cilin nuk do të kryhet rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar

(b) Kur bartësi dëshiron të rinovojë regjistrimin ndërkombëtar në lidhje me palën nënshkruese të përcaktuar, duke mos neglizhuar faktin se periudha maksimale e mbrojtjes për dizajnët industrial tek ajo palë nënshkruese ka skaduar, pagesa e taksës së kërkuar, përfshirë taksën standarde për përcaktim ose taksën individuale për përcaktim, varësisht nga rasti, për atë palë nënshkruese, do të shoqërohet me deklaratë se rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar do të regjistrohet në regjistrin ndërkombëtar në lidhje me atë palë nënshkruese.

(c) Kur bartësi dëshiron të rinovojë regjistrimin ndërkombëtar në lidhje me palën nënshkruese të përcaktuar, duke mos neglizhuar faktin se refuzimi është regjistruar në regjistrin ndërkombëtar për atë palë nënshkruese; pagesa e taksës së kërkuar, përfshirë edhe taksën standarde për përcaktim ose taksën individuale për përcaktim, varësisht nga rasti, për atë palë nënshkruese, do të shoqërohet me deklaratë se rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar do të regjistrohet në regjistrin ndërkombëtar në lidhje me atë palë nënshkruese.

(d) Regjistrimi ndërkombëtar mund të mos jetë shënuar në lidhje me ndonjë palë nënshkruese të përcaktuar nëse është shënuar anulim për të gjithë dizajnet industrial sipas Rregullit 20 ose në lidhje me refuzim të regjistruar sipas rregullit 21. Regjistrimi ndërkombëtar mund të mos jetë regjistruar në lidhje me ndonjë palë nënshkruese të përcaktuar për ato dizajne industrial për të cilët është regjistruar anulimi në atë palë nënshkruese sipas Rregullit 20 ose në lidhje me kufizimet e përshkruara sipas Rregullit 21.

(3) (Taksa të palejuara) (a) Në qoftë se shuma që është pranuar në emër të taksave është më e vogël se shuma e kërkuar për rinovim, Byroja ndërkombëtare menjëherë do të njoftojë, në të njëjtën kohë që të dy, bartësin dhe përfaqësuesin, nëse ka të tillë. Në njoftim do të specifikohet shuma që mungon.

(b) Në qoftë se shuma nga paragrafi (1)(c) është më e vogël se shuma që kërkohet për rinovim, Byroja ndërkombëtare nuk do të regjistrojë rinovimin, do t'i kthejë shumat e pranuar dhe menjëherë do të njoftojë bartësin dhe përfaqësuesin, nëse ka të tillë.

Rregulli 25 ***Regjistrimi i rinovimit; Vendimi***

(1) (Regjistrimi i datës së hyrjes në fuqi të rinovimit) Rinovimi do të regjistrohet në Regjistrin ndërkombëtar në datën në të cilin ai maturohet, madje edhe sikur taksat e kërkuara për rinovim të jenë të paguara në periudhë të cekur në rregullin 24(1)(c).

(2) (Vendimi) Byroja ndërkombëtare do të dërgojë vendimin për rinovim deri tek bartësi.

KAPITULLI 6 ***BULETINI***

Rregulli 26 ***Buletin***

(1) (Informacione në lidhje me regjistrimet ndërkombëtare) Byroja

ndërkombëtare do të shpallë në Buletin të dhënat relevante:

- (I) Regjistrimet ndërkombëtare, sipas rregullit 17;
- (II) Refuzime të regjistruara sipas 18(5), me përcaktim se a ka mundësi për shqyrtim ose ankesë, por pa bazë për refuzim;
- (III) Anulimet e regjistruara në Rregullin 20(2);
- (IV) Ndryshimet në pronësi, ndryshimet në emrin ose adresën e bartësit, refuzimet dhe kufizimet e regjistruara sipas rregullit 21;
- (V) Korrigjimet e futura sipas rregullit 22;
- (VI) Rinovime të regjistruara sipas rregullit 25(1);
- (VII) Regjistrimet ndërkombëtare që nuk do të rinovohen

(2) (Informacione në lidhje me deklarata dhe lloje tjera informacionesh) Byroja ndërkombëtare do të shpallë në Buletin të gjitha deklaratat e bëra nga palët nënshkruese sipas këtij Akti dhe kësaj Rregullore, njëjtë sikur që edhe listën e ditëve në të cilët Byroja ndërkombëtare nuk është e hapur për publikun gjatë vitit aktual dhe atij të ardhshëm kalendarik.

(3) (Numri i kopjeve për Entin e palëve nënshkruese) (a) Byroja ndërkombëtare do t'i dërgojë Entit të çdo palë nënshkruese kopje të buletinit. Çdo Ent do të marrë falas nga dy kopje dhe nëse në vitin kalendarik numri i përcaktimeve për atë palë nënshkruese është maksimum 500, në vitin e ardhshëm edhe një kopje plotësuese dhe kopje të mëtutjeshme për çdo 500 përcaktime të reja që tejkalojnë numrin prej 500. Çdo palë nënshkruese mund të blejë çdo vit, me çmim përgjysmë të parapagesës, numër të njëjtë të kopjeve që i fiton falas.

(b) Nëse buletini është në dispozicion në më shumë se një formë, secili Ent mund të zgjedhë formën në të cilën dëshiron të pranoj kopjet.

KAPITULLI 7 TAKSAT

Rregulli 27 Shuma dhe pagesa e taksave

(1) (Shuma e taksave) shumat e taksave në lidhje me Aktin dhe këtë Rregullore, që nuk janë taksa individuale për përcaktim të cekura në Rregullin 12(1)(a)(III), do të specifikohen në Listën e taksave që janë aneks në këtë Rregullore dhe janë në formë të pjesës së saj integrale.

(2) (Pagesa) (a) Lëndë e nënparagrafit 9(6) dhe Rregullit 12(3)(c), taksat do të paguhen drejtpërdrejt në Byronë ndërkombëtare.

(b) Kur aplikacioni ndërkombëtar është dorëzuar përmes Entit të palës nënshkruese të aplikuesit, taksat që paguhen në lidhje me aplikacionin mund

të paguhen përmes ati Enti në qoftë se ai pranon edhe të grumbullojë dhe ridërgojë ato taksa dhe nëse aplikuesi ose bartësi e dëshirojnë këtë. Çdo ent që pranon të grumbullojë taksat do të njoftojë drejtorin gjeneral për këtë fakt.

(3) (Mënyra e pagesës) Taksat do t'i paguhen Byrosë ndërkombëtare sipas udhëzimeve administrative.

(4) (Caktime mbi pagesat) Gjatë pagesës së çdo takse në Byronë ndërkombëtare duhet të jepen caktimet si në vijim:

- (I) Para regjistrimit ndërkombëtar, emri i aplikuesit, dizajni industrial për të cilin bëhet fjalë dhe qëllimi i pagesës,
- (II) Pas regjistrimit ndërkombëtar, emri i bartësit, numri i regjistrimit ndërkombëtar për të cilin bëhet fjalë dhe qëllim i pagesës.

(5) (Data e pagesës) (a) Lëndë e rregullit 24(1)(d) dhe nënparagrafit (b) do të konsiderohet çdo taksë që është paguar në Byronë ndërkombëtare në datën kur Byroja ndërkombëtare e ka pranuar shumën e kërkuar.

(b) Kur shuma e kërkuar është në dispozicion nga llogaria e hapur tek Byroja ndërkombëtare dhe kur Byroja ka marrë udhëzime nga bartësi i llogarisë që të ngarkojë atë, do të konsiderohet se taksa i është paguar Byrosë ndërkombëtare në ditën kur Byroja ndërkombëtare ka pranuar aplikacionin ndërkombëtar, kërkesën për regjistrim të ndryshimit ose udhëzime për rinovimin e regjistrimit ndërkombëtar.

(6) (Ndryshime në shumën e taksave) (a) Kur aplikacioni ndërkombëtar është dorëzuar përmes Entit të palës nënshkruese të aplikuesit dhe kur në ndërkohë është ndryshuar tarifa e taksave që duhet të paguhen për dorëzimin e aplikacionit ndërkombëtar nga njëra anë, datën në të cilën aplikacioni ndërkombëtar është pranuar në Ent dhe, nga ana tjetër, data e pranimit të aplikacionit ndërkombëtar, taksa që ka qenë e vlefshme në ditët e para, do të zbatohet.

(b) Kur shuma e taksave që duhet të paguhen në lidhje me rinovimin e regjistrimit ndërkombëtar është ndryshuar midis datës së pagesës dhe datës së rinovimit, do të zbatohet taksa që ka pas vlefshmëri në datën pagesës ose në datën që konsiderohet për datë të pagesës sipas rregullit 24(1)(d). Kur pagesa është bërë pas asaj date, do të zbatohet taksa që kanë qenë e vlefshme në datën në fjalë.

(c) Kur shuma e taksës që është e ndryshme nga taksat e cekura në nënparagrafët (a) dhe (b) është ndryshuar, do të zbatohet tarifa (shuma) që është e vlefshme në datën në të cilën taksa është pranuar në Byronë ndërkombëtare.

Rregulli 28

Valuta në pagesë

(1) (Obligim për përdorim të valutës zvicerane) Të gjitha pagesat që bëhen sipas kësaj marrëveshje në Byronë ndërkombëtare, do të jenë në valutë zvicerane, pa marrë parasysh faktin se, kur këto paguhen përmes Entit, ai Ent mund t'i grumbulloj ato në valutë tjetër .

(2) (Vendosja e shumës së taksave individuale për përcaktim në valutë zvicerane)

(a) Kur pala nënshkruese dorëzon deklaratë sipas nenit 7(2) se dëshiron të pranojë taksën për përcaktim individual, shuma e taksës dorëzuar deri te Byroja ndërkombëtare, do të shprehet në valutën që e përdor Enti i saj.

(b) Kur taksa që është cekur në deklaratë, cekur në nënparagrafin (a) që është në valutë zvicerane, Drejtori gjeneral, pas konsultimeve me Entin e palës nënshkruese për të cilën bëhet fjalë, do të vendos shumën (tarifën) e taksës në valutë zvicerane në bazë të kursit zyrtar të Kombeve të Bashkuara.

(c) Kur, për më shumë se tre muaj të njëpasnjëshëm kursi i Kombeve të Bashkuara midis valutës zvicerane dhe valutës në të cilën shuma e taksave për përcaktim individual është caktuar nga Pala nënshkruese, është më i lartë ose më i ulët, por më së paku 5% nga kursi i fundit i aplikueshëm në shumën e taksës në valutë zvicerane, Enti i palës nënshkruese mund të kërkojë që drejtori gjeneral të vendosi shumë të re të taksave në valutë zvicerane, sipas kursit zyrtar të Kombeve të Bashkuara, derisa llogaritet dita që i paraprin ditës kur është dorëzuar kërkesa, drejtori gjeneral do të veprojë menjëherë. Shuma e re do të zbatohet në datën e caktuar nga drejtori gjeneral, duke parashikuar se ajo datë është midis një dhe dy muaj pas datës së shpalljes së shumës në fjalë në Buletin.

(d) Kur për më shumë se tre muaj të njëpasnjëshëm kursi zyrtar i Kombeve të Bashkuara midis valutës zvicerane dhe valutës në të cilën shuma e taksave për përcaktim individual ishin caktuar nga Pala nënshkruese është më e vogël, por të paktën 10 % nga kursi i fundit i aplikuar në shumën e taksave në valutën zvicerane, drejtori gjeneral do të vendos shumë të re të taksës në valutën zvicerane, në përputhje me kursin zyrtar ekzistues të Kombeve të Bashkuara. Shuma e re do të zbatohet në datën e përcaktuar nga drejtori gjeneral, duke parashikuar që ajo datë është midis një dhe dy muaj pas datës së shpalljes së shumës në fjalë në Buletin.

Rregulli 29

Kreditimi i taksave nga llogaritë e palëve nënshkruese

Çdo taksë për përcaktim standard apo individual që duhet t'i paguhet Byrosë ndërkombëtare, në lidhje me palën nënshkruese do të kreditohet nga llogaria e asaj pale nënshkruese tek Byroja ndërkombëtare gjatë muajit, që vijon pas muajit në të cilin është regjistruar regjistrimi ndërkombëtar ose rinovimi

ndërkombëtar për të cilat ajo taksë duhet të paguhet, ose, në kuptim të pjesës së dytë të taksës për përcaktim individual, menjëherë pas pranimit në Byronë ndërkombëtare.

KAPITULLI 8
APLIKACIONE NDËRKOMBËTARE QË BIEN EKSKLUZIVISHT OSE
PJESËRISHT NËN AKTIN E 1934 DHE REGJISTRIMET
NDËRKOMBËTARE ADEKUATE QË REZULTOJNË NGA TO

Rregulli 30

Zbatimi i kësaj rregullore në aplikacione ndërkombëtare që bien
tërësisht ose pjesërisht nën Aktin e 1934 dhe regjistrimet
ndërkombëtare adekuate që rezultojnë nga to

(1) [Parim i përgjithshëm] Nëse nuk është specifikuar ndryshe dhe nëse është përmbushur paragrafi (2), kjo Rregullore do të zbatohet mbi aplikacione ndërkombëtare që ekskluzivisht bien nën aktin e 1934 dhe mbi regjistrimet ndërkombëtare që rezultojnë nga to.

(2) [Përrjashtime] (a) Duke përjashtuar Rregullin 6, çdo aplikacion ndërkombëtar që bie ekskluzivisht nën Aktin e 1934 do të jetë në gjuhën franceze.

(b) Duke përjashtuar Rregullin 7(5)(a), përshkrimi i riprodhimit ose i veçorive karakteristike të dizajnit industrial dhe të identitetit të kreatorit (krijuesit) të dizajnit industrial, nuk duhet të përfshihen në aplikacion që ekskluzivisht bie nën aktin e 1934.

(c) Duke përjashtuar Rregullin 7(5)(e), prolongimi i shpalljes nuk mund të kërkohet me aplikacione që ekskluzivisht bien nën Aktin e 1934.

(d) Duke përjashtuar Rregullin 7(7), dizajni industrial që përmbahet në aplikacionin ndërkombëtar që bie ekskluzivisht nën aktin e 1934 mund të bie në klasa të ndryshme të Klasifikimi ndërkombëtar.

(e) Duke përjashtuar Rregullin 9(1), aplikacioni ndërkombëtar që ekskluzivisht bie nën Aktin e 1934, në vend se të përmbaj aplikacione mund të përmbajë kopje (mostra).

(f) Duke përjashtuar Rregullin 12(1), për aplikacionin ndërkombëtar që ekskluzivisht bie nën Aktin e 1934, do të paguhet vetëm taksa bazë e cekur në Rregullin 12 (1)(a)(i)

(g) Duke përjashtuar Rregullin 15(1), riprodhimet e dizajnëve industrial që përmbahen në aplikacionin ndërkombëtar që ekskluzivisht bie nën Aktin e 1934, nuk do të regjistrohen në Regjistrin ndërkombëtar.

(h) Duke përjashtuar Rregullin 17(1), regjistrimi ndërkombëtar që

rezulton nga aplikimi ndërkombëtar që ekskluzivisht bie nën aktin e 1934, do të shpallet menjëherë pas regjistrimit.

(i) Duke përjashtuar Rregullin 17(2)(ii), riprodhimet e dizajneve industriale që përmbahen në regjistrimin ndërkombëtar, që rezulton nga aplikacioni ndërkombëtar që ekskluzivisht bie nën Aktin e 1934, nuk do të shpallen në Buletin.

(j) Duke përjashtuar Rregullin 18, efektet nga regjistrimi ndërkombëtar që rezulton nga aplikacioni ndërkombëtar që ekskluzivisht bie nën aktin e 1934 nuk mund t'i nënshtrohet njoftimit për refuzim dhe të mbrojtjes;

(k) Duke përjashtuar Rregullin 21(3), ndryshimi i pronarit nuk do të mund të regjistrohet në lidhje me palën nënshkruese të përcaktuar sipas Aktit të 1934, nëse mbi baza të indikacioneve të cekura në rregullin 21(2)(iv), Aktit të 1934 do të ndalonte të viente në raport me atë palën nënshkruese.

(l) Duke përjashtuar Rregullin 24(1)(a), regjistrimi ndërkombëtar që është rezultat i aplikacionit ndërkombëtar që bie nën Aktin e 1934, do të shpallet pas pagesës vetëm të taksës bazë të cekur në Rregullin 24(1)(i).

(m) Duke përjashtuar Rregullin 24(1)(b), regjistrimi ndërkombëtar që është rezultat i aplikacionit ndërkombëtar që bie ekskluzivisht nën aktin e 1934 nuk do të vazhdohet aty ku periudha e mbrojtjes ndërkombëtare prej 15 vite, e cekur në nenin 7 të Aktit të 1934, nuk skadon.

(n) Rinovimi i regjistrimit ndërkombëtar, që është rezultat i aplikacionit ndërkombëtar që bie ekskluzivisht nën aktin e 1934, për periudhën e dytë të mbrojtjes prej 10 viteve të cekur në nenin 7 të Aktit të 1934, mund të kërkohet gjatë kohës së dorëzimit të të njëjtit aplikacion. Në atë rast, taksa e cekur në Rregullin 24(1)(a)(i) për dorëzimin e aplikacionit ndërkombëtar dhe në rast se kjo nuk ndodh, kërkesa për rinovim do të injorohet nga Byroja ndërkombëtare.

(3) [Aplikacione ndërkombëtare të vulosur] (a) Aplikacioni ndërkombëtar që bie ekskluzivisht nën Aktin e 1934 përkrah indikacioneve të cekura në Rregullin 7(3), do të përmbajë dhe indikacion mbi atë se a është dorëzuar ai aplikacion si i vulosur ose si i mbyllur.

(b) Pas skadimit të periudhës së parë të mbrojtjes ndërkombëtare prej 5 viteve të cekur në nenin 7 të aktit të 1934, çdo regjistrim ndërkombëtar i vulosur (mbyllur) do të hapet nga Byroja ndërkombëtare në momentin e rinovimit të regjistrimit të lartpërmendur.

Rregulli 31

Zbatimi i kësaj rregullore në Aplikacionet ndërkombëtare që pjesërisht bien nën Aktin e 1934 si dhe i regjistrimeve ndërkombëtare që rezultojnë nga to

(1) [Parimi gjeneral] Kjo rregullore do të zbatohet mbi aplikacionet ndërkombëtare të cekura në Rregullin 1 (1)(xviii) deri (xx), dhe në regjistrimet ndërkombëtare që dalin nga to, nëse plotësojnë edhe paragrafin (2).

(2) [Përjashtime] (a) Duke përjashtuar Rregullin 7(5)(e), prolongimi i publikimi

nuk mund të kërkohet për aplikacion ndërkombëtar të cekur në paragrafin (1). Aty ku është kërkuar dh e ku një nga palët e përcaktuara nënshkruese është përcaktuar sipas Aktit të 1934, Byroja ndërkombëtare do të njoftojë aplikuesin adekuat; në qoftë se, në periudhë prej një muaji nga data e dërgimit të njoftimit nga ana e Byrosë ndërkombëtare, aplikuesi, përmes kërkesës me shkrim deri te Byroja ndërkombëtare nuk tërheq përcaktimin (shënjinin) e palës së cekur nënshkruese, Byroja ndërkombëtare nuk do ta marr parasysht kërkesën për prolongim të shpalljes.

(b) Duke përjashtuar rregullin 21 (3), ndryshimi i pronësisë nuk mund të kryhet në lidhje me palën nënshkruese të përcaktuar, nëse në bazë të indikacioneve të cekura në rregullin 21(2)(iv), Akti i 1934 nuk do të vlente në raport me atë palë nënshkruese.

(c) Për palë nënshkruese që janë përcaktuar sipas aktit të 1934 në aplikacion ndërkombëtar nga paragrafi (1) ose në regjistrime ndërkombëtare që rezultojnë nga to

- (i) Taksat e cekura në rregullin 12(1)(a)(ii) deri (iv) nuk do të paguhen,
- (ii) Efektet nga regjistrimi adekuat ndërkombëtar nuk do t'i nënshtrohen notifikimit (procesit të njoftimit) për refuzim të mbrojtjes së cekur në Rregullin 18;
- (iii) Taksat për rinovim të cekura në rregullin 24(1)(a)(ii) dhe (iii) nuk do të paguhen;
- (iv) Regjistrimi adekuat ndërkombëtar nuk do të vazhdohet aty ku periudha e mbrojtjes prej 15 viteve, e cekur në nenin 7 të aktit të 1934, ka skaduar, me përjashtim të Rregullit 24(2)(b).

KAPITULLI 9 TË NDRYSHME

Rregulli 32

Ekstrakte, kopje dhe informacione në lidhje me Regjistrimet ndërkombëtare të shpallur

(1) [Modalitete] Pas pagesës së taksës, shuma e së cilës do të përcaktohet në Listën e taksave, çdokush mund të marrë nga Byroja ndërkombëtare këtë në vijim, për cilindo regjistrim ndërkombëtar të shpallur:

- (i) Ekstrakte nga Regjistri ndërkombëtar;
- (ii) Kopje të certifikuara nga shkresa të bëra në Regjistrin ndërkombëtar ose pjesë të dosjeve të regjistrimit ndërkombëtar;
- (iii) Kopje jo të certifikuara të shkresave të bëra në Regjistrin ndërkombëtar ose pjesë të dosjeve të regjistrimit ndërkombëtar;
- (iv) Informacione të shkruara për përmbajtjen e Regjistrimit ndërkombëtar ose për dosjet e regjistrimit ndërkombëtar;

(2) [Lirim nga autenticiteti, legalizimi ose çfarëdo certifikimi tjetër] Në lidhje me dokumentin e cekur në paragrafin (1)(i) dhe (ii) që bartë vulën e Byrosë ndërkombëtare dhe nënshkrimin e drejtorit gjeneral ose të personit që vepron në emrin e tij, asnjë autoritet nga cilado palë nënshkruese nuk guxon të kërkojë autenticitet, legalizim apo çfarëdo personi tjetër apo autoritet. Ky paragraf zbatohet mutatis mutandis mbi certifikatën e regjistrimit ndërkombëtar të cekur në Rregullin 15 (1).

Rregulli 33 **Plotësime të rregullave ekzistuese**

(1) (Kërkesë për unanimitet) Plotësimi i dispozitave vijuese nga kjo Rregullore do të kryhet me unanimitet:

(I) Rregulli 13(4)

(I) Rregulli 18(1)

(2) (Kërkesë për shumicë prej katër të pestave) Plotësimi i dispozitave në vijim nga kjo Rregullore dhe paragrafi (3) nga ky rregull do të kryhet me shumicë prej katër të pestave:

(I) Rregulli 7(6);

(II) Rregulli 9(3)(b)

(III) Rregulli 16(1);

(IV) Rregulli 17(1)(III).

(3) (Procedura) Çdo propozim për plotësim të dispozitave të cekura në paragrafit (1) ose (2) do t'i dërgohet të gjitha palëve nënshkruese të paktën dy muaj para seancës së Kuvendit që është thirrur për sjelljen e Vendimit sipas atij propozimi.

Rregulli 34 **Udhëzime administrative**

(1) (Sjellja e udhëzimeve administrative: Çështje të mbuluara nga ato) (a) Drejtori gjeneral do t'i sjellë udhëzimet administrative. Drejtori gjeneral mund t'i modifikojë të njëjtat. Drejtori gjeneral do të konsultojë Entet që kanë interes të drejtpërdrejt në udhëzimet e propozuara administrative ose në modifikimet e tyre të propozuara.

(b) Udhëzimet administrative kanë të bëjnë me çështjet në lidhje me të cilat kjo Rregullore qartë referohet dhe në lidhje me detajet për zbatimin e kësaj Rregullore.

(2) (Kontrolli nga Kuvendi) Kuvendi mund të ftojë drejtorin gjeneral ta ndryshoj cilëndo dispozitë të udhëzimeve administrative dhe drejtori gjeneral do të veprojë menjëherë.

(3) (Shpallja e datës së hyrjes në fuqi) (a) Udhëzimet administrative dhe çdo

ndryshim i tyre do të shpallen në Buletin.

(b) Çdo shpallje do të përmbajë datën në të cilën dispozitat e shpallura hyjnë në fuqi. Datat mund të jenë të ndryshme për dispozita të ndryshme, duke parashikuar se asnjë nga dispozitat nuk mund të hyjë në fuqi pa shpalljen e tyre në Buletin.

(4) (Konflikt midis Aktit dhe kësaj Rregullore) Në rast të konfliktit midis dispozitave të udhëzimeve administrative dhe dispozitave të Aktit ose të kësaj Rregullore, këto të fundit do të zbatohen.

Rregulli 35

Deklarata nën Aktin e 1999 të bëra nga palët nënshkruese

(1) [Përpilimi dhe hyrja në fuqi e Deklaratave] Neni 30(1) dhe (2) i Aktit të 1999 do të zbatohet mutatis mutandis në përpilimin e çfarëdo qoftë deklarate sipas rregullave 8(1), 9(3)(a), 13(4) ose 18(1)(5), si dhe drejt hyrjes në fuqi të tyre.

(2) [Tërheqja nga Deklaratat] Çdo deklaratë nga paragrafi (1) mund të tërhiqet në çfarëdo kohe me njoftim të adresuar deri te Drejtori gjeneral. Kjo tërheqje do të hyjë në fuqi pas pranimit të njoftimit nga ana e drejtorit gjeneral ose nga ndonjë datë e mëvonshme e cekur në vetë njoftimin. Në rast të deklaratës të përpiluar sipas rregullit 18(1)(b), tërheqja nuk do të ketë efekt mbi regjistrimin ndërkombëtar data e së cilës është më e hershme se hyrja në fuqi e tërheqjes në fjalë.

Rregulli 36

Deklarata nën Aktin e 1960 të bëra nga palët nënshkruese

(1) [Taksë individuale për caktim] Për qëllimin e nenit 15(1)2(b) të Aktit të 1960, cilado palë nënshkruese e Aktit të 1960, Enti i së cilës kryen ekzaminime (shqyrtime) të inovacioneve mund, me deklaratë ta njoftojë drejtorin gjeneral se në lidhje me çdo aplikacion ku ai është përcaktuar sipas aktit të 1960, taksa standarde për përcaktim e cekur në Rregullin 12(1)(a)(II) do të zëvendësohet me taksë individuale për përcaktim, shuma e së cilës do të përcaktohet në deklaratë dhe e cila mund të ndryshohet në deklaratat e mëvonshme. Shuma e caktuar nuk guxon të jetë më e madhe se ekuivalenti i asaj që Byroja e asaj pale nënshkruese do të ishte në gjendje të paguaj për dhënien e të drejtës së mbrojtjes për periudhë ekuivalente për numër të njëjtë të dizajneve industrial, zvogëluar për kursimet që dalin nga procedurat ndërkombëtare.

(2) [Maksimumi, Kohëzgjatja e mbrojtjes] Secila palë nënshkruese e Aktit të

1960, përmes deklaratës do të njoftojë Drejtorin gjeneral për kohëzgjatjen maksimale të mbrojtjes të lejuar me ligjin e saj.

(3) [Koha kur nuk mund të dorëzohen Deklarata] Cila do qoftë deklaratë sipas paragrafëve (1) dhe (2) mund të dorëzohet

- (i) Në kohën e deponimit të instrumentit të cekur në Nenin 26(2) të Aktit të 1960, me ç'rast do të hyjë në fuqi në datën në të cilën shteti që ka sjellë këtë deklaratë do të bëhet i obliguar me Akt, ose
- (ii) Pas deponimit të instrumentit të caktuar në nenin 26(2) të Aktit të 1960, me ç'rast ajo do të hyjë në fuqi një muaj nga data e pranimin nga ana e drejtorit gjeneral ose në cilindo datë të mëvonshme të cekur në vetë deklaratën por do të ketë ndikim në cilindo regjistrim ndërkombëtar data ndërkombëtare e regjistrimit e të cilit është e njëjta ose e mëvonshme se data efektive e deklaratës.